

RAPORT
I PUNËS SË FONDIT TË SIGURIMIT PENSIONAL
DHE INVALIDOR TË MAQEDONISË SË VERIUT
PËR VITIN 2021

Shkup, maj 2022

PËRMBAJTJA	fq.
I. HYRJE	4
II. TË DHËNA STATISTIKORE	7
1. Numri i të siguruarve	7
2. Përfituesit e pensionit	11
3. Përfituesit me shumë më të ulët të pensionit	16
4. Përfituesit e kompensimit në të holla me aftësi të kufizuara për punë	17
5. Përfituesit e kompensimit në të holla për dëmtim trupor	18
6. Pjesëmarrja e të dalave për sigurim pensional dhe invalidor në bruto prodhimin vendor	19
III. HARMONIZIMI I PENSIONEVE	20
IV. PUNA FINANCIARE E FONDIT	22
1. Të hyrat e Fondit	23
2. Të dalat e Fondit	29
3. Rezultati financiar	35
4. Aksionet dhe pjesët	36
5. Pagesa e kontributeve të mbetura të papaguara	37
V. REALIZIMI I TË DREJTËS DHE ZBATIMI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR	37
1. Raporti për realizimin e të drejtës nga SPI-ja në shkallë të parë	37
2. Rregullimi ligjor, monitorimi dhe zbatimi i dispozitave juridike dhe të vepruarit sipas parashtrësave	42
3. Realizimi i të drejtave të SPI-së sipas dispozitave të BE-së dhe marrëveshjeve ndërkombëtare	43
4. Komisioni për vlerësimin e aftësisë për punë	45
5. Evidentimi amë	50
6. Pagesa e pensioneve	52
7. Zbatimi i kompetencave nga shtylla e dytë pensionale	53
VI. ORGANET E MANXHIMIT TË FONDIT	54
1. Këshilli Drejtues	54

2. Drejtori	56
VII. SHËRBIMI PROFESIONAL I FONDIT	57
1. Revizioni i brendshëm	57
2. Koordinimi i buxhetit	59
3. Kontrolli i buxhetit	60
4. Furnizimet publike	61
5. Burimet njerëzore	63
6. Informimi	67
7. Punët juridike	69
8. Ekonomizimi i pronës së Fondit	71
9. Fondi solidar	74
VIII. SISTEMI INFORMATIK	77
1. Zhvillimi i sistemit informatik	77
2. Softueri aplikativ	78
3. Infrastruktura dhe mbështetja e TI-së	78
IX. KONKLUZË	79

RAPORT

I PUNËS SË FONDIT TË SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR TË MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2021

I. HYRJE

Sigurimi pensional dhe invalidor në çdo vend zë një vend të rëndësishëm në jetën e përgjithshme shoqërore, sociale dhe politike të popullsisë. Lëvizjet e përgjithshme ekonomike, sociale dhe demografike në shoqëri ndikojnë në zhvillimin e sistemit pensional të çdo vendi, ndërsa rëndësia e tij shprehet nëpërmjet numrit të të siguarve (të punësuarve), të cilët paguajnë kontribut për sigurim pensional dhe invalidor, lartësia e shkallës së kontributit që paguhet, numri i përfituesve të pensionit dhe lartësia e tij, si dhe pjesëmarrja e të dalave për sigurim pensional dhe invalidor në bruto prodhimin vendor në vend.

Në Raportin e punës së Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut për vitin 2020 përfshihen të dhëna të detajuara individuale dhe gjithëpërfshirëse me arsyetime mbi rezultatet e realizuara gjatë zbatimit të tyre në RMV. Raporti vjetor përmban të dhëna statistikore për realizimin e të drejtës nga sigurimi pensional dhe invalidor, të dhënat financiare për punën e Fondit, evidentimi amë, standardi shoqëror i përfituesve të pensionit etj. Aktivitetet e Fondit janë të shumta dhe ato kanë ndikim ndaj popullatës më të moshuar në vend, ndërsa në mënyrë indirekte edhe ndaj anëtarëve të familjarëve të tyre.

Sistemi i sigurimit pensional dhe invalidor në Republikën e Maqedonisë së Veriut që nga viti 2006 funksionon si sistem treshtyllësh, si vijon:

-Sigurimi i detyrueshëm pensional dhe invalidor në bazë të solidaritetit të gjeneratave (shtylla e parë),

-Sigurimi i detyrueshëm pensional me financim kapital (shtylla e dytë) dhe

-Sigurimi pensional vullnetar në bazë të kursimit të kapitalizuar individual (shtylla e tretë).

Në shtyllën e parë dhe të dytë nga sistemi i detyrueshëm pensional janë përfshirë të gjithë të punësuarit në bazë të marrëdhënies së punës dhe realizimit të aktiviteteve në bazë të ndryshme, përderisa shtylla e tretë është në bazë vullnetare.

Puna e Fondit është kryer në pajtim me Ligjin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor, Ligjin e Sigurimit të Detyrueshëm Pensional me Financim Kapital, Ligjin e Kontributeve të Sigurimit të Detyrueshëm Social, Buxhetin e Fondit, Programin e punës së Këshillit Drejtues të Fondit dhe Planin strategjik të Fondit.

Në kuadër të sigurimit pensional dhe invalidor, sigurimin e tyre social e realizojnë 337.317 përfitues të së drejtës së sigurimit pensional dhe invalidor, përkatësisht 328.570 përfitues të pensionit, 8.685 përfitues të kompensimit në të holla për dëmtim trupor dhe 62 përfitues të kompensimit në të holla me aftësi të kufizuara për punë, apo 16,19% nga gjithsej popullsia e Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2021 (e vlerësuar me 2.083.000), ndërsa pjesëmarrja e shpenzimeve të përgjithshme për sigurim pensional dhe invalidor (80.147,07 milion denarë) në bruto prodhimin vendor (723.239,00 milion denarë) arrin 11,08%, përderisa për pagesën e pensioneve 8,63%.

Organet e menaxhimit të Fondit janë Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Fondit. Sipas nenit 156, paragrafi (2) të Ligjit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor (Gazeta Zyrtare e RM-së nr.98/2012), Këshilli Drejtues i Fondit numëron shtatë anëtarë të cilët i emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me një mandat prej katër vjetësh. Nga ky numër, dy anëtarë emërohen me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe pesë anëtarë me propozim nga: Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale, Ministria e Financave, Sindikata Përfaqësuese, anëtare e Këshillit Ekonomiko – Social, Shoqata Përfaqësuese e Punëdhënësve, gjithashtu anëtare e Këshillit Ekonomiko – Social dhe Lidhja e Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë.

Nga viti 2012 në pajtim me nenin 120 të Ligjit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor (Gazeta Zyrtare e RM-së 98/2012), shkalla e kontributit, e cila shpërndahet për shtyllën e dytë arrin 6% nga baza fikse për pagesën e kontributit, të përcaktuar me ligj, ndërsa në shtyllën e parë shpërndahen 12,8% nga shkalla e përgjithshme prej 18,8% nga kontributi i paguar për vitin 2021.

Në fund të vitit 2021, numri i të siguruarve arriti 572.303, përderisa numri i përfituesve të pensionit arriti 328.570 përfitues (së bashku me përfituesit minimal bujqësor dhe ushtarak), ose në raport 1,74 të siguruar në 1 pensionist.

Në vitin 2021 Fondi realizoi gjithsej të hyra në shumë prej 81.508,27 milion denarësh dhe gjithsej të dala në shumë prej 80.147,07 milion denarësh, gjegjësisht tepricë e të hyrave mbi të dalat prej 1.361,2 milion denarë. Në punën financiare të Fondit në vitin 2021 ndikoi mosrealizimi i treguesve makroekonomik të parashikuar. Për këto arsye është përgatitur dhe miratuar Ribalanci i Buxhetit të Fondit.

Në vitin 2021, Fondi bëri harmonizimin e pensioneve. Nga 1 janari i vitit 2021 u harmonizuan për 1,2%, nga 1 korriku i vitit 2021 u harmonizuan 1,2% apo gjithsej 2,4%.

Me harmonizimin e bërë të pensioneve, pensioni mesatar në dhjetor të vitit 2021 (nga e drejta e punës) arriti në 15.856 denarë dhe në raport me vitin 2020 (15.461) është më e lartë për 2,5%, ndërsa së bashku me pensionet minimale bujqësore dhe ushtarake, pensioni mesatar në vitin 2021 arrin në 15.876 denarë, ndërsa në vitin 2020 ai arriti 15.483 denarë dhe është zmadhuar për 2,5%.

Në vitin 2021, Fondi udhëheqte politikën kadrovike në mbështetje me masat antikrizë të Qeverisë, që mos të pranohen punonjës të rinj në vendet e lira në bazë të pensionimit dhe bazave të tjera në pajtim me Ligjin e Marrëdhënieve të Punës.

Me zbatimin e Projektit për mbështetje teknike mbi dizajnimin e proceseve të reja afariste për realizimin e të drejtës dhe pagesës së pensioneve, në vitin 2021, në mënyrë të konsiderueshme është shkurtuar afati për zgjidhjen e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor dhe pagesës së pensioneve.

Në dhjetor të vitit 2021 u paguan gjithsej pensione për 328.570 përfitues të pensionit (me pensione ushtarake dhe minimale bujqësore), në shumë mesatare mujore të të dalave prej 5.190,80 milion denarësh në neto shumë dhe 674,80 milion denarë kontribut për sigurim shëndetësor apo gjithsej 5.865,60 milion denarë.

Në vitin 2021 nga shitja e aksioneve dhe pjesëve të fituara nga Fondi në bazë të Ligjit të Transformimit të Ndërmarrjeve me Kapital Shoqëror, të realizuara me të hyra në shumë prej 12,84 milion denarësh. Për shkak të pandemisë, mjetet e planifikuara për rekreacion klimatik – në banjë të përfituesve të pensionit, nuk u realizuan.

II. TË DHËNA STATISTIKORE

1. Numri i të siguarve

Në bazë të evidentimit të amzës së Fondit të Sigurimit Pensionsal dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut me gjendje në dhjetor të vitit 2021 janë evidentuar 85.132 obligues dhe 572.303 të siguar me sigurim të detyrueshëm pensionsal dhe invalidor.

Tabela 1. Numri i të siguarve dhe obliguesve në dhjetor të vitit 2021

Nr.rendor	Filiale	Të obliguar	Të siguar
1	Berovë	1.037	3.857
2	Manastir	4.583	33.770
3	Vallandovë	562	2.646
4	Veles	2.493	14.618
5	Vinicë	649	4.809
6	Gjevgjeli	1.838	11.715
7	Gostivar	3.795	14.150
8	Dibër	741	3.200

9	Dellçevë	858	5.749
10	Demir Hisar	448	2.107
11	Kavadar	2.385	17.609
12	Kërçovë	1.585	10.401
13	Koçan	1.838	12.480
14	Kratovë	248	1.378
15	Kriva-Pallankë	727	3.954
16	Krushevë	576	1.442
17	Kumanovë	3.653	21.915
18	Makedonski Brod	223	1.560
19	Negotinë	1.330	5.764
20	Ohër	2.777	18.386
21	Përlep	5.779	23.953
22	Probishtip	472	3.458
23	Radovish	1.638	5.666
24	Resnjë	922	3.436
25	Shën Nikollë	1.015	4.209
26	Strugë	2.520	11.865
27	Strumicë	5.498	23.001
28	Tetovë	6.473	30.646
29	Shtip	2.058	21.260
30	Shkup	26.411	253.299
Gjithsej		85.132	572.303


Sipas të dhënave të Fondit, numri i të siguruarve (me gjendje në dhjetor të vitit 2021) për të cilët paguhet kontribut prej 8 deri 12 muaj arrin 540.091 apo 94,37% nga gjithsej numri i të siguruarve (572.303).

Tabela nr.2: Numri i përfituesve të pensionit dhe numri i personave të siguruar


Viti	Numri i të punësuarve	Numri i përf. të pensionit (pa përfitues mini.bujq. dhe ushtarak)	Numri i përfitues. të pensionit në 1000 të siguruar	Numri i të siguruarve në 1 përfitues të pensionit
2007	424.338	272.386	693	1,6
2008	451.491	273.281	654	1,7
2009	475.780	273.977	576	1,7
2010	466.280	273.751	587	1,7
2011	489.608	277.441	567	1,8
2012	507.061	282.334	557	1,8
2013	526.909	289.114	549	1,8
2014	536.191	293.860	548	1,8
2015	558.821	299.640	536	1,9
2016	570.168	305.766	536	1,9
2017	575.574	310.744	540	1,9
2018	578.023	315.780	546	1,8
2019	581.405	322.704	555	1,8
2020	571.863	325.125	569	1,8
2021	572.303	327.535	572	1,7

Numri i të siguruarve të regjistruar në dhjetor të vitit 2021 në raport me dhjetor të vitit 2020 është zmadhuar për 440 të siguruar.

Numri i të siguruarve, përfituesve të pensionit dhe raporti i tyre janë dhënë në grafikun vijues:




Struktura e të siguarve sipas gjinisë në dhjetor të vitit 2021 është dhënë në grafikun vijues:



Nga gjithsej numri i të siguarve në vitin 2021, 124.497 të siguar janë burra dhe 110.234 gra të moshës prej 35-50 vjeç, ndërsa prej 50-64 vjeç numri i të siguarve burra arrin 90.616 dhe gra 61.096, ndërsa të siguarit e tjerë janë të kategorive të tjera.

Struktura e pleqërisë e të siguarve në dhjetor të vitit 2021 është dhënë në grafikun vijues:



2. Përfituesit e pensionit

Numri i përfituesve të pensionit nga sigurimi i punës, pensionet ushtarake dhe bujqësore me gjendje më 31.12.2021.

Tabela_nr. 3_ Numri i përfituesve të pensionit në dhjetor të vitit 2020 dhe 2021


Lloji i pensionit	Përfitues të pensionit 31.12.2020	Përfitues të pensionit 31.12.2021	Rritja/zvogëlimi	Indeksi 2021/2020
Pleqërie	218.815	222.123	3.308	101,5
Invalidore	32.169	30.000	-2.169	93,3
Familjare	74.141	75.412	1.271	101,7
Gjithsej	325.125	327.535	2.410	100,7
Ushtarake	1.080	961	-119	89,0
Bujqësore	90	74	-16	82,2

Gjithsej pensione:	326.295	328.570	2.275	100,7
--------------------	---------	---------	-------	-------

Përveç pensioneve të rregullta, ushtarake dhe bujqësore, Fondi paguan edhe kompensim për dëmtim trupor për 8.685 përfitues, prej të cilëve 1.761 janë përfitues me dëmtim trupor si e drejtë e vetme nga sigurimi pensional dhe invalidor.

Numri i përfituesve të pensionit në vitin 2021 (së bashku me pensionet minimale bujqësore dhe ushtarake) në krahasim të vitit 2020, është më i lartë për 2.275 përfitues të pensionit apo për 0,7%. Përfituesit e pensioneve minimale bujqësore dhe ushtarake do të reduktohen me defluks natyror, për shkak se përdoruesit e gjetur të drejtën e tyre e realizuan sipas dispozitave ligjore të cilat tashmë nuk zbatohen, ndërsa nuk realizohen të drejta të reja.

Struktura e përfituesve të pensionit sipas llojit të pensionit paraqitet në vijim:



Fluksi i përfituesve të rinj të pensionit të pleqërisë prej vitit 2007 deri në vitin 2021 është dhënë në grafikun vijues:





Tabela nr.4: Shkalla e rritjes së përfituesve të pensionit prej vitit 2007 - 2021 sipas llojit të pensionit

Periudha	Përfitues të rinj të pensionit të pleqërisë	Përfitues të rinj të pensionit invalidor	Përfitues të rinj të pensionit familjar	Gjithsej
2007-2006	2,2	-2,7	1,1	1,0
2008-2007	-0,3	1,1	1,0	0,3
2009-2008	0,3	-1,3	1,2	0,3
2010-2009	1,2	-3,8	-0,3	-0,1
2011-2010	2,7	1,9	1,0	1,3
2012-2011	3,9	-2,8	0,1	1,8
2013-2012	4,5	-2,1	0,5	2,4
2014-2013	4,0	-3,5	-0,7	1,6
2015-2014	3,9	-3,5	0,5	2,0
2016-2015	4,2	-3,7	-0,1	2,0

2017-2016	3,5	-3,6	-0,5	1,6
2018-2017	3,6	-3,6	-0,9	1,6
2019-2018	4,2	-4,0	-0,2	2,2
2020-2019	2,8	-6,0	-1,9	0,8
2021-2020	1,5	-6,7	1,7	0,7

Rritja e numrit të përfituesve të pensionit prej vitit 2007 – 2021 është paraqitur në grafikun vijues:




Fluksi i përfituesve të pensionit invalidor edhe në vitin 2021 u reduktua për shkak të ndryshimeve në Ligjin e Sigurimit Pensionsal dhe Invalidor.

Tabela nr.5: Lëvizja e numrit të përfituesve të pensionit nga sigurimi i punës, sipas viteve:

Viti	Pension pleqërie	Pension invalidor	Pension familjar	Gjithsej
2007	150.075	48.364	74.257	272.696
2008	149.682	48.562	75.037	273.281
2009	150.092	47.947	75.937	273.976
2010	151.894	46.118	75.739	273.715

2011	156.016	44.895	76.530	277.441
2012	162.086	43.648	76.600	282.334
2013	169.362	42.741	77.011	289.114
2014	176.157	41.245	76.458	293.860
2015	182.954	39.814	76.872	299.640
2016	190.633	38.343	76.790	305.766
2017	197.383	36.970	76.391	310.744
2018	204.455	35.645	75.680	315.780
2019	212.941	34.217	75.546	322.704
2020	218.815	32.169	74.141	325.125
2021	222.123	30.000	75.412	327.535

Paraqitje grafike e lëvizjes së numrit të përfituesve të pensionit



Sipas grafikut të dhënë, del se numri i përfituesve është në rritje edhe në vitin 2021 më shumë se gjysma apo 67,82% nga gjithsej numri i përfituesve të pensionit janë përfitues të pensionit të pleqërisë, ndërsa pjesa tjetër ka të bëjë me përfituesit e pensionit familjar dhe invalidor.

3. Përfitues me shumë më të ulët të pensionit

Tabela nr.6: Numri dhe lartësia e pensionit të përfituesve me shumë më të ulët të pensionit

	Numri i përfituesve	Shuma e pensionit (denarë)
Grupi i parë		
Pensione të realizuara deri 31.12.1996	1.664	12.801,00
Pensione të realizuara prej 1997-2001	401	11.146,00
Pensione të realizuara pas 2001	6.355	11.703,00
Gjithsej grupi i parë (mbi 35 vjet burra dhe mbi 30 vjet gra)	8.420	
Grupi i dytë		
Pensione të realizuara deri 31.12.1996	2.354	12.547,00
Pensione të realizuara prej 1997-2001	892	10.568,00
Pensione të realizuara pas 2001	16.187	11.095,00
Gjithsej grupi i parë (mbi 25 vjet burra dhe mbi 20 vjet gra)	19.433	
Grupi i tretë		
Pensione të realizuara deri 31.12.1996	6.778	12.222,00
Pensione të realizuara prej 1997-2001	3.185	9.986,00
Pensione të realizuara pas 2001	42.993	10.487,00
Gjithsej grupi i parë (mbi 25 vjet burra dhe mbi 20 vjet gra)	52.956	
Gjithsej:	80.809	

Shuma më e ulët e pensionit përcaktohet pavarësisht nga lartësia e pensionit, e përcaktuar në bazë të kohëzgjatjes së stazhit pensional dhe pagave të realizuara. Kjo do të

thotë se, të siguarit i garantohet një shumë e pensionit që është më e lartë se pensioni i përcaktuar nga kohëzgjatja e stazhit pensional dhe pagat e realizuara. Instituti me shumë më të ulët të pensionit bazohet në parimin e drejtësisë sociale, ku lartësia e tij varet nga lartësia e kontributit të punës, i shprehur nëpërmjet kohëzgjatjes së stazhit pensional edhe pse ajo është më e ulët, përfituesit i paguhet deri në pensionin më të ulët.

4. Përfituesit e kompensimit në të holla me aftësi të kufizuara për punë

Në Fond, në fund të vitit 2021 kishte 62 përfitues, prej të cilëve 50 në periudhën e pritjes për punësim në punën e tyre apo ndonjë punë tjetër përkatëse, 4 përfitues me orar të shkurtuar të punës dhe 8 përfitues, për shkak të të ardhurave më të ulëta personale, në ndonjë punë tjetër përkatëse.

Pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të Ligjit të SPI-së (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 153/2007), të gjithë përfituesit e kompensimit në të holla, në bazë të aftësisë së ngelur për punë, të cilët kanë mbushur mbi 50 vjet, u riemëruan në pension invalidor në bazë të aftësisë së zvogëluar për punë.

Përfituesit (me ndonjë ndryshim të caktuar të Republikës të punës apo orar të shkurtuar të punës) të cilët nuk ishin të moshës 50 vjeçe, edhe më tej mbetën të punojnë në ndonjë punë tjetër apo me orar të shkurtuar të punës dhe ende shfrytëzojnë kompensim në të holla.

Tabela nr.7: Numri i përfituesve të kompensimit në të holla prej vitit 2007 – 2021

Lloji i të drejtës viti	Pritje për punësim	Orar i shkurtuar pune	Pagë më e ulët	Të tjera	Gjithsej
2007	1768	67	113	0	1948
2008	202	15	8	0	225
2009	183	14	9	0	206

2010	158	13	6	0	177
2011	145	16	10	0	171
2012	94	13	9	0	116
2013	95	13	9	0	117
2014	81	6	23	0	110
2015	81	6	23	0	110
2016	72	5	9	0	86
2017	72	5	9	0	86
2018	72	5	9	0	86
2019	72	5	9	0	86
2020	50	4	8	0	62
2021	50	4	8	0	62

5. Përfituesit e kompensimit në të holla për dëmtim trupor

Përfituesit e kompensimit në të holla për dëmtim trupor janë të siguarit, të cilët është shkaktuar humbje, dëmtim serioz, apo gjymti më e rëndësishme e aftësisë për punë në disa organe apo pjesë të trupit, gjë e cila e vështirëson aktivitetin normal të organizmit dhe kërkon përpjekje më të madhe në realizimin e nevojave jetësore, pa marrë parasysh nëse shkakton apo nuk shkakton invalidim.

Të drejtën e kompensimit në të holla për dëmtim trupor i siguruari e fiton pavarësisht nga ajo se a ka fituar dhe se a shfrytëzon ndonjë të drejtë tjetër nga sigurimi pensional dhe invalidor.

Numri i përfituesve të cilët pranojnë kompensim në të holla për dëmtim trupor në vitin 2021 arrinte 8.685 përfitues, prej të cilëve 1.761 përfitues të të drejtës së vetme dhe 6.924 përfitues me të drejtë pensioni. Numri i përfituesve të dëmtimit trupor në vitin 2021 në raport me vitin 2021 është zvogëluar për 356 përfitues apo për 4,1%.

6. Pjesëmarrja e të dalave për sigurim pensional dhe invalidor në prodhimin vendor bruto

Pjesëmarrja e të dalave për sigurim pensional dhe invalidor, prodhimi vendor bruto dhe krahasimi i tyre janë paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela nr.8: Të dalat për SPI-në, BPV-në dhe pjesëmarrja e të dalave në BPV

Viti	Gjithsej të dala për SPI-në	BPV-ja	Pjesëmarrja e të dalave për SPI-në në BPV
	në million denarë		
2007	32.770	333.845	9,8
2008	38.733	405.014	9,6
2009	41.393	396.496	10,4
2010	42.507	425.628	10,0
2011	44.306	455.387	9,7
2012	46.227	476.072	9,7
2013	50.854	474.196	10,7
2014	54.017	518.380	10,4
2015	56.789	552.286	10,3
2016	61.488	579.646	10,6
2017	65.149	630.859	10,3
2018	68.544	660.308	10,4
2019	73.122	697.431	10,5
2020	77.213	664.010	11,6
2021	80.147	723.239	11,1

Pjesëmarrja e të dalave për sigurim pensional dhe invalidor në vitin 2021 në raport me BPV-në arrin 11,1%. Pjesëmarrja e të dalave për pensione në vitin 2021 arrin 8,6% në raport me BPV-në vitin e njejtë.

III. HARMONIZIMI I PENSIONEVE

Sipas nenit 3 të Ligjit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.98/2012...245/2018, 180/2019) dhe nenit 1, paragrafi (4) dhe (5) të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.275/2019, 31/2020 dhe 267/2020), si dhe shpallja për lëvizjen e shpenzimeve për jetë në RMV, pensionet e realizuara deri më 31.12.2020, nga 1 janari i vitit 2021 harmonizohen për 1,2%, pensionet e realizuara deri më 30.6.2021 nga 1 korriku i vitit 2021 harmonizohen për 1,2% apo gjithsej 2,4%.

Harmonizimi i pensioneve në periudhën prej vitit 2007 deri në vitin 2021 është paraqitur në pasqyrën vijuese:

Tabela nr.9: Harmonizimi i kryer i pensioneve prej vitit 2007-2021

Viti	Harmonizimi i pensioneve më 1 janar	Harmonizimi i pensioneve më 1 korrik	Gjithsej harmonizimi
2007	0,64%	1,04%	1,69%
2008	13,00%	7,65%	21,66%
2009	3,50%	2,02%	5,59%
2010	0,30%	1,10%	1,40%
2011	0,75%	2,10%	2,87%
2012	0,31%	1,40%	1,71%
2013*	1,15%	0,75%	+5% допол. Вкуп.


			7%
2014	5% од февруари	0,00%	5,00%
2015	0,00%	5% од септември	5,00%
2016	0,00%	5% од ноември	5,00%
2017	0,82%	0,76%	1,59%
2018	1,69%	1,80%	3,52%
2019	0,70%	0,40%	1,10%
2020	5% (722 денари)	0,60%	722 + 0,60%
2021	1,20%	1,20%	2,40%

*Harmonizim i rregullt dhe plotësues

Me harmonizimet e realizuara të pensioneve, pensioni mesatar në dhjetor të vitit 2021 arrinte 15.876,00 denarë dhe ai në raport të vitit 2020 në shumë prej 15.483,00 denarë është më e lartë për 2,50%. Rritja është rezultat i harmonizimit të rregullt të pensioneve në vitin 2020 si dhe lartësisë së pensioneve të përfituesve të rinj të pensionit.

Tabela nr.10: Pensionet mesatare sipas llojit, në dhjetor të vitit 2020 dhe 2021 arrijnë si vijon:

Lloji i pensionit	2020	2021	Indeksi
	në denarë		
Pension pleqërie	16.703	17.140	102,6
Pension invalidor	13.980	14.296	102,3
Pension familjar	12.437	12.696	102,1
GJITHSEJ	15.461	15.856	102,6
Pension bujqësor	8.051	8.264	102,6
Pension ushtarak	22.782	23.108	101,4
GJITHSEJ	15.483	15.876	102,5



Pensioni mesatar i paguar së bashku me pensionet ushtarake dhe pensionet minimale të bujqëve në dhjetor të vitit 2021 arrin 15.876 denarë dhe në raport me pagën në dhjetor të vitit 2021 arrin 53,0% si vijon: 17.140,00 denarë për pension pleqërie, 14.296,00 denarë për pension invalidor dhe 12.696,00 denarë për pension familjar.

IV. PUNA FINANCIARE E FONDIT

Me Buxhetin e Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 si dhe me Ribalancin e Buxhetit të Fondit, si pjesë përbërëse e Buxhetit të Republikës, ishte planifikuar që puna financiare e Fondit të realizohet me të hyra dhe të dala të ribalancuara sipas treguesve makroekonomikë për rritjen e të hyrave nga kontributet për 5,3% (2,9% nga rritja e paraparë e pagave dhe 2,4% rritja e punësimeve si dhe shkalla e kontributit për SPI-në prej 18,8%), si dhe sigurimin e mjeteve nga Buxheti i Republikës për obligimet e rregullta ligjore, për shpenzimet transitive dhe mbulimin e deficitit të Fondit. Rritja e pagave është faktor i rëndësishëm për llogaritjen dhe pagesën e kontributit për sigurim pensional dhe invalidor si dhe rritja e

punësimeve, e cila ndikon shumë në realizimin e të hyrave të Fondit. Në pjesën e të dalave ishte projektuar pagesa e rregullt e pensioneve dhe rritja ligjore e pensioneve nga janari dhe nga korriku i vitit 2020 si dhe rritja e numrit të përfituesve të pensionit prej 1,80% në nivel vjetor.

Në gjendjen financiare të Fondit ndikonte edhe shkalla e kontributit për sigurim pensional dhe invalidor, e cila në vitin 2021 arrinte 18,8% në mbështetje të Ligjit të Kontributeve nga Sigurimi i Detyrueshëm Social, si dhe aktivitetet e ndërmarra të Fondit për pagesën e kontributeve të mbetura, përfundimisht deri më 31.12.2008, për të cilin janë paguar mjete në shumë prej 78,11 milion denarësh.

Me mjetet e realizuara nga kontributet, si dhe me mjetet e dedikuara nga Buxheti i Republikës, nga të hyrat e akcizave dhe të hyrave tjera jotatimore, Fondi në vitin 2021 realizoi gjithsej të hyra në shumë prej 81.508,27 milion denarësh. Me këto mjete dhe me mjetet e bartura nga viti 2020 (4.924,21 milion denarë), Fondi realizoi gjithsej të dala në shumë prej 86.432,48 milion denarësh.

Fondi edhe në vitin 2021 rregullisht realizonte pagesën e pensioneve në afatet e përcaktuara, javën e parë të muajit për muajin paraparak duke shfrytëzuar edhe hua nga Buxheti i Republikës vetëm në muajin janar në shumë prej 450,00 milion denarësh, ndërsa të njëjtën e kthente pas pagesës së akumulimit të mjeteve nga kontributet.

Gjithsej të hyrat e realizuara në Fond në vitin 2021 në raport me mjetet e planifikuara me Ribalancim të Buxhetit të Fondit arrijnë 101,06%, ndërsa në krahasim me vitin 2020 ato janë më të larta për 4,92%, ndërsa gjithsej të dalat janë në nivel të mjeteve të planifikuara me Ribalancimin e Buxhetit apo 99,37%, ndërsa në krahasim me vitin 2020 ato janë më të larta për 3,80%.

1. Të hyrat e Fondit

Gjithsej të hyrat e Fondit të realizuara në vitin 2021 janë në shumë prej 81.508,27 milion denarësh dhe janë nga burimet vijuese të financimit:

- **Nga të hyrat burimore** (kontribut nga paga, stazhi i sigurimit me kohëzgjatje të shtuar, kontribut nga personat fizikë, të cilët në mënyrë të pavarur kryejnë veprimtari, të punësuar tek ata si dhe nga bujqit individualë dhe nga Agjencia e Punësimit) janë realizuar mjete në shumë prej 47.472,52 milion denarësh apo 58,24% nga gjithsej të hyrat,

- **Mjetet nga Buxheti i Republikës** janë realizuar në shumë prej 30.580,30 milion denarësh apo 37,52% nga gjithsej të hyrat.

- **Nga akcizat** janë realizuar mjete në shumë prej 1.462,14 milion denarësh apo 1,79% nga gjithsej të hyrat,

- **Nga dividenda** janë realizuar mjete në shumë prej 11,67 milion denarësh, të cilat në krahasim me gjithsej të hyrat arrijnë 0,01%.

- **Nga shitja** e aksioneve dhe pjesëve janë realizuar 12,84 milion denarë apo 0,02%.

- **Nga të hyrat e tjera** janë realizuar mjete në shumë prej 151,97 milion denarësh apo 0,19% nga gjithsej të hyrat.

Kontributi nga paga për vitin 2021 paguhet në shkallë prej 18,8% të bruto pagës dhe është burim kryesor për financimin e Fondit. Të gjitha kontributet e paguara nga paga Fondit i shpërndan ndërmjet shtyllës së parë dhe të dytë pensionale, sipas Ligjit të ri të Sigurimit Pensional dhe Invalidor datë 8.8.2012, me të cilën u përcaktua në shkallë fikse për shtyllën e dytë prej 6% ndërsa për shtyllën e parë prej 12,8%, si dallim ndërmjet shkallës së kontributit të përgjithshëm dhe shkallës së kontributit për shtyllën e dytë.

Në vitin 2021 nga kontributet e pagës, janë realizuar mjete në shumë prej 47.472,52 milion denarësh dhe ato arrijnë 101,68% në raport me mjetet e planifikuara me Buxhetin e Fondit, ndërsa në krahasim me vitin 2020 janë më të larta për 6,32% apo 2.823,23 milion denarë. Pjesëmarrja e kontributit të pagës në të hyrat totale arrin 58,24%. Në rritjen e kontributit nga paga në vitin 2021 ndikoi edhe rritja e shkallës së kontributit prej 18,8%, si dhe vendimi i Qeverisë për mbulimin e një pjese të kontributit për pagë të obliguesve, për shkak të krizës së kovidit, rritja e madhe e pagave, ndërsa pjesëmarrje të vogël kishte edhe pagesa e rritur e kontributit dhe pagesa e kontributeve të mbetura përfundimisht më 31.12.2008, në shumë prej 78,11 milionë denarësh.

Kontributi i pagës sipas muajve në vitin 2021 dhe 2020 lëviz sipas dinamikës së mëposhtme:

Tabela nr.11: Kontributi nga paga sipas muajve

Muaji	Pagesa e kontributeve		Indeksi 2021/2020	Dallimi
	2021	2020		
Janar	3.238,20	3.125,11	103,62	113,09
Shkurt	3.824,88	3.774,71	101,33	50,17
Mars	3.951,74	3.619,31	109,18	332,43
Prill	4.203,65	3.752,90	112,01	450,75
Maj	3.605,85	3.394,53	106,23	211,32
Qershor	4.094,63	3.645,51	112,32	449,12
Korrik	4.336,31	4.122,92	105,18	213,39
Gusht	3.528,17	3.384,98	104,23	143,19
Shtator	3.841,28	3.762,20	102,10	79,08
Tetor	3.820,38	3.742,55	102,08	77,83
Nëntor	4.064,06	3.631,82	111,90	432,24
Dhjetor	4.963,37	4.692,75	105,77	270,62
Gjithsej	47.472,52	44.649,29	106,32	2.823,23

Në tabelë shihet se kontributi nga paga në vitin 2021 në raport me vitin 2020 është më i lartë për 6,32%, ndërsa sipas muajve realizim më të madh ka në mars, prill, qershor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2021.

Të hyrat nga kontributi i të ardhurave (553,61 milion denarë), të hyrat nga personat fizikë, që kryejnë veprimtari dhe të punësuarit tek ato (1.086,97 milion

denarë), si dhe nga bujqit individualë (172,69 milion denarë) janë realizuar në shumë prej 1.813,27 milion denarësh dhe pjesëmarrja e tyre në të hyrat e përgjithshme arrin 2,22%.

Të hyrat nga Agjencia e Punësimit u dedikohet personave të papunë, të cilët pranojnë kompensim në të holla. Në vitin 2021 sipas kësaj baze janë dedikuar mjete në shumë prej 3,56 milion denarësh dhe ato në krahasim me vitin 2020 (4,52 milion denarë) janë më të ulëta për 0,96 milion denarë apo për 21,24%, ndërsa pjesëmarrja e tyre në të hyrat e përgjithshme të Fondit arrin vetëm 0,004%. Këto mjete nga viti në vit reduktohen për shkak të zvogëlimit të numrit të personave për të cilët paguhet kontribut për shkak të ndryshimit të dispozitave ligjore dhe paguhet kontribut vetëm për personat të cilët nuk kanë 15 vjet përvojë pune.

Të hyrat nga akcizat janë realizuar në shumë prej 1.462,14 milion denarësh dhe ato në të hyrat e përgjithshme marrin pjesë me 1,79%. Këto të hyra llogariten sipas shkallës prej 9,18% nga derivatet e naftës. Në krahasim me vitin 2020 të hyrat nga akcizat janë më të larta për 9,52%, ndërsa në raport me të planifikuarat janë më të larta për 4,44%.

Mjetet transferuese nga Buxheti i Republikës janë realizuar në shumë prej 30.580,30 milion denarësh dhe ato janë realizuar në raport me mjetet e planifikuara me Buxhetin e Fondit (99,85%), ndërsa në krahasim me të hyrat e realizuara në vitin 2020 (29.852,40 milion denarë) janë më të larta për 2,45%. Mjetet e dedikuara i referohen:

- 3.000,00 milion denarë për obligime ligjore (për përfituesit e pensioneve minimale të bujqëve, pensioneve ushtarake, luftëtarë para dhe pas datës 9.9.1943, përfitues në ngarkesë të Republikës, mësuesit, përfitues në SHNP (shtëpia ndëshkimore përmirësuese), si dhe për pagesën e dallimeve në bazë të harmonizimit prej 8% për periudhën e kaluar, në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të RMV-së).

- 9.300,00 milion denarë për shpenzimet transitive,

- 17.766,00 milion denarë për mbulimin e deficitit rrjedhës,

- 514,30 milion denarë transfer nga Ministria e Mbrojtjes, ndërsa i dedikohen pagesës së pensioneve të realizuara sipas Ligjit të Shërbimit në ARM.

Pjesëmarrja e të hyrave nga Buxheti i Republikës në të hyrat e përgjithshme të Fondit arrin 37,52%, ndërsa pjesëmarrja e deficitit rrjedhës në transferin e përgjithshëm arrin 58,09% dhe ai nga viti në vit shënoi rritje. Mjetet nga Buxheti i Republikës janë të hyra të dyta për nga madhësia dhe janë shkallë e rëndësishme në financimin e sigurimit pensional dhe invalidor. Të hyrat nga Buxheti i Republikës rregullisht janë dedikuar pas llogaritjeve të dorëzuara paraprake mujore nga ana e Fondit.


Të hyrat nga dividenda dhe nga shitja e aksioneve dhe pjesëve në vitin 2021 janë realizuar në shumë prej 24,59 milion denarësh si vijon:

- **Nga dividenda** janë realizuar mjete në shumë prej 11,67 milion denarësh dhe ato arrijnë 116,07% nga të hyrat e realizuara me Ribalancin e buxhetit,

- **Nga shitja e aksioneve dhe pjesëve** në vitin 2021 janë realizuar të hyra prej 12,84 milion denarësh dhe arrijnë 64,2% nga të planifikuarat me Ribalancin e buxhetit

- **Nga të hyrat e tjera** janë realizuar mjete në shumë prej 151,97 milion denarësh dhe ato arrijnë 101,3% në krahasim me të planifikuarat, ndërsa në raport me vitin 2020 janë më të larta për 6,41. Të hyrat e tjera i referohen: 15,60 milion denarë nga të hyrat e qirasë, 21,19 milion denarë nga kompensimi dhe dëmi, 11,69 milion denarë nga pensionet e kthyer nga vendet e huaja, 82,18 milion denarë nga kontributet e realizuara nga periudha e kaluar, 0,71 milion denarë nga valutat e kthyer të pensioneve nga jashtë, 0,79 milion denarë nga mjetet e kthyer nga Fondi solidar, 11,14 milion denarë interes për pagesën e vonuar të kontributeve për SPI-në, 9,51 milion denarë kompensim nga fondet private për kryerjen e veprimtarisë së Fondit dhe 0,84 milion denarë nga kontribute të tjera.

Struktura e të hyrave paraqitet në vijim:



Sipas strukturës së të ardhurave, në të ardhurat e përgjithshme është pjesëmarrja e kontributit të pagës prej 58,24% nga Buxheti i Republikës me pjesëmarrje prej 37,52% apo sipas dy bazave 95,76% përdërisa nga të gjitha të ardhurat e tjera të mjetëve të realizuara marrin pjesë me 4,24% në të hyrat e përgjithshme.

Tabela nr. 12: Të hyrat e realizuara dhe të planifikuara të Fondit në vitin 2021

Nr.rendor	Lloji i të hyrave	Ribalanci i Buxhetit për vitin 2021	Të realizuara I-XII 2020	Të realizuara I-XII 2021	Indeks 4:2	Indeks 4:3
0	1	2	3	4	5	6
1	Kontribut nga paga	46.688,00	44.649,29	47.472,52	101,68	106,32
2	Kontribut nga të hyrat	560,00	539,70	553,61	98,86	102,58

3	Sektori privat	1.050,00	1.008,96	1.086,97	103,52	107,73
4	Bujq individualë	150,00	139,39	172,69	115,13	123,89
5	Të hyra nga Agjencia e Punësimit	3,00	4,52	3,56	118,67	78,76
	Gjithsej kontribute	48.451,00	46.341,86	49.289,35	101,73	106,36
6	Të hyra nga akcizat	1.400,00	1.334,88	1.462,14	104,44	109,53
7	Transfer nga Buxheti i Republikës	30.626,00	29.852,40	30580,30	99,85	102,44
8	Të hyra tjera	150,00	142,81	151,97	101,31	106,41
9	Të hyra nga dividenda	10,00	10,69	11,67	116,70	109,17
10	Të hyra nga shitja e letrës me vlerë	20,00	0,00	12,84	64,20	0,00
	Gjithsej të hyra	80.657,00	77.682,64	81.508,27	101,06	104,92

2. Të dalat e Fondit

Me Buxhetin e Fondit për vitin 2021 në pjesën e të dalave në mbështetje të indikatorëve makroekonomik është projektuar pagesë e rregullt e pensioneve dhe harmonizimi i të njejtave prej 1 janarit dhe 1 korrikut të vitit 2021, si dhe rritja e numrit të përfituesve të pensionit prej 1,81% në nivel vjetor.

Të dalat totale të Fondit në vitin 2021 arrijnë 80.147,07 milion denarë dhe ato janë realizuar në nivel të mjeteve të planifikuarat me Buxhetin e Fondit, përkatësisht 99,37%, ndërsa janë më të larta për 9,61% në raport me të dalat e realizuara në vitin 2020.

Të dalat e Fondit janë si vijon:

- **Të dalat për pagesën e pensioneve** arrijnë 62.289,66 milion denarë (61.999,40 milion denarë për pensionet e rregullta, 281,63 milion denarë për pensionet ushtarake dhe 8,63 milion denarë për pensionet bujqësore) apo 77,72% nga gjithsej të dalat.

- **Kontributi për sigurim shëndetësor** për përfituesit e pensionit arrin 8.068,37 milion denarë gjegjësisht 13% e shumës së pensionit të përlllogaritur dhe ai në gjithsej të dalat merr pjesë me 10,07%. Të dalat për pensionet e paguara së bashku me kontributin për sigurim shëndetësor arrijnë 70.358,03 milion denarë dhe ato në gjithsej të dalat marrin pjesë me 87,79%.

- **Të dalat për pagesën e kompensimeve nga sigurimi invalidor, vendosjen e fëmijëve invalid në konvikt dhe dëmtim trupor** arrijnë 86,38 milion denarë apo 0,11% nga gjithsej të dalat. Kompensimet nga sigurimi invalidor arrijnë 3,06 milion denarë dhe ato në krahasim me të dalat e vitit 2020 janë më të ulëta. Kompensimi për dëmtim fizik arrin 83,27 milion denarë dhe është më i lartë në raport të vitit 2020, ndërsa për vendosje në konvikt 0,05 milion denarë që është më pak se një vit më parë.

- **Transferimi i mjeteve për fondet pensionale private** në vitin 2021 arrin 9.233,14 milion denarë dhe ato në gjithsej të dalat marrin pjesë me 11,52%. Këto të dala janë në nivel të mjeteve të planifikuara me Buxhetin e Fondit (99,28%), ndërsa për 7,07% janë më të larta në krahasim me vitin 2020. Numri i të siguarve - anëtarë në fondet pensionale private në fund të vitit 2020 arrinte 529.983 (me gjendje më 31.12.2020) dhe ai më 31.12.2021 arrinte 550.477 anëtarë apo më shumë për 20.494 anëtarë, gjegjësisht 3,87% për shkak të anëtarësimit të detyrueshëm të të gjithë të punësuarve të rinj në fondet pensionale private. Të dalat për pagesë drejtuar fondeve pensionale private arrijnë 11,52% nga gjithsej të dalat e Fondit.

Këto mjete kompensohen nëpërmjet transferit nga Buxheti i Republikës.

- **Pagat e të punësuarve në shërbimin profesional** të Fondit në vitin 2022 arrijnë 261,76 milion denarë apo 0,33% në raport të gjithsej të dalave. Të dalat e zbatuara për pagat e të punësuarve në Shërbimin profesional janë në nivel të mjeteve të

planifikuara, ndërsa në krahasim me vitin 2020 janë më të larta për 1,65%. Numri i të punësuarve me gjendje në dhjetor të vitit 2021 arrin 535 të punësuar.

- **Të dala të tjera** në vitin 2021 janë zbatuar në shumë prej 173,17 milion denarësh apo 0,22% në raport të gjithsej të dalave. Këto shpenzime në raport të të planifikuarave janë zbatuar me 77,08% dhe në krahasim me të zbatuarat nga viti 2020 janë më të ulëta për 32,00%.

- **Shpenzimet kapitale** janë zbatuar në shumë prej 19,30 milion denarësh, të cilat në krahasim me mjetet e planifikuara për këtë qëllim në shumë prej 21,80 milion denarë përfaqësojnë realizim prej 88,53%. Në vitin 2021 këto mjete janë shpenzuar për blerjen e pajisjeve informatike dhe të zyrave.

- **Shpenzimet për rikonstruimin e objekteve afariste** janë zbatuar në shumë prej 15,29 milion denarësh, edhe atë për rikonstruimin e objekteve në Qendrën në Shkup, Shtip, Probishtip, si dhe në shtëpitë për jetesë të përfituesve të pensionit në Aerodrom Shkup.

- **Furnizim i automjeteve** nuk është realizuar për shkak të pandemisë, ndërsa me propozim nga Qeveria mjetet për këtë qëllim nuk duhet të shpenzohen.

Struktura e të dalave në vijim:




Tabela nr.13: Gjithsej të dalat e Fondit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nr. rend.	Lloji i të dalave	Buxhet për vitin 2021	Realizuar I-XII 2020	Realizuar I-XII 2021	Indeks 4:2	Indeks 4:3
0	1	2	3	4	5	6
1	Gjithsej pensione	62.398,00	60.298,35	62.372,93	99,96	103,44
2	Pagesë në bazë të sigurimit të detyrueshëm me financim kapital	9.675,00	8.612,15	9.233,14	95,43	107,21
3	Kompensim për sigurim invalidor	4,00	3,71	3,06	76,50	82,48
4	Kontribut për sigurim shëndetësor	8.080,00	7.881,72	8.068,37	99,86	102,37
5	Paga dhe kompensime	262,91	257,52	261,76	99,56	101,65
6	Të dala tjera, shpenzime kapitale dhe rikonstruim të objekteve afariste	237,09	159,77	207,81	87,65	130,07
	Gjithsej të dala	80.657,00	77.213,22	80.147,07	99,37	103,80

Tabela nr. 14: Lëvizja e të hyrave sipas viteve në milion denarë

Viti	Të hyra burimore	Agjencia e Punësimit	Buxheti	Akcizat	Të hyra tjera	Dividenda	Shitja e aksioneve	Gjithsej
2007	21.914,23	864,98	10.378,52	681,04	151,89	5,88	56,71	34.053,25
2008	25.581,91	773,58	10.181,99	717,4	247,71	21,48	97,63	37.621,70
2009	26.279,53	256,49	14.020,85	744,49	194,11	19,41	74,64	41.589,52
2010	26.137,49	163,9	14.218,12	787,57	112,17	10	40,78	41.470,03
2011	26.890,36	122,19	15.704,97	813,77	122,23	7,22	276,35	43.937,09
2012	27.659,80	84,25	17.503,34	851,03	149,65	3,44	119,12	46.370,63

2013	28.655,98	50,76	21.060,83	870,16	142,69	2,25	287,56	51.070,23
2014	29.876,77	30,87	22.677,71	892,39	290,74	0,66	11,54	53.780,68
2015	32.214,89	21,22	23.860,89	1016,11	125,70	0,09	15,52	57.254,51
2016	33.819,77	14,22	26.599,48	1.120,71	109,79	0,21	20,78	61.684,96
2017	35.606,13	7,77	28.457,04	1.154,21	91,79	3,04	0,00	65.319,96
2018	37.982,50	7,90	29.391,94	1.346,96	102,76	3,55	16,86	68.852,47
2019	41.921,18	5,92	28.098,22	1.378,61	4.472,58	8,48	30,54	75.915,53
2020	46.337,34	4,52	29.852,40	1.334,88	142,81	10,69	0,00	77.682,64
2021	49.285,79	3,56	30.580,30	1.462,14	151,97	11,67	12,84	81.508,27

Gjithsej të hyrat në vitin 2021 në raport të vitit 2007 janë rritur për 224,90%, ndërsa mjetet nga Buxheti i Republikës për 294,65%. Të hyrat nga Agjencia e Punësimit janë zvogëluar në mënyrë drastike nga viti 2009, për shkak të ndryshimit të dispozitave ligjore lidhur me fitimin e të drejtës , si dhe me bazat dhe përqindjen e llogaritjeve për realizim.




Tabela nr. 15_Lëvizja e të hyrave sipas viteve

Viti	Pensione	Kompensime nga sigurimi Invalidor	Kontributi nga shëndetësia	Shërbimi profesional	Shpenzime tjera kapitale	Shpenzimet tranzitive	Gjithsej
------	----------	-----------------------------------	----------------------------	----------------------	--------------------------	-----------------------	----------


2007	26.305,27	247,79	3.714,03	240,33	385,13	1.877,00	32.769,55
2008	30.953,74	115,58	4.367,89	256,16	549,24	2.490,53	38.733,14
2009	33.537,64	107,53	4.290,57	264,64	260,39	2.932,20	41.392,97
2010	34.437,32	103,52	4.338,25	251,55	203,89	3.172,93	42.507,46
2011	35.751,31	101,65	4.524,32	273,81	172,07	3.482,61	44.305,77
2012	37.292,59	100,65	4.798,82	257,28	177,93	3.599,49	46.226,76
2013	40.812,95	100,57	5.359,18	247,34	193,43	4.141,29	50.854,76
2014	43.931,60	97,45	5.421,47	241,31	187,3	4.138,32	54.017,45
2015	45.569,34	94,71	5.954,22	248,63	202,47	4.719,99	56.789,36
2016	48.248,22	91,83	6.335,8	249,17	189,49	6.373,96	61.488,47
2017	51.820,97	90,22	6.571,29	241,88	171,45	6.253,13	65.148,94
2018	54.227,72	90,68	6.827,33	232,19	158,47	7.007,81	68.544,20
2019	56.318,10	91,33	7.437,42	228,82	185,19	8.861,58	73.122,44
2020	60.212,53	89,53	7.881,72	257,52	159,77	8.612,15	77.213,22
2021	62.289,61	86,38	8.068,37	261,76	207,81	9.233,14	80.147,07

Në periudhën prej vitit 2007 deri në vitin 2021, gjithashtu janë rritur edhe të dalat si rezultat i rritjes së numrit të përfituesve të pensionit dhe harmonizimit të zbatuar të pensioneve.

Të dalat për pagesën e pensioneve në vitin 2021 arrijnë 62.289,61 milion denarë dhe në krahasim me vitin 2007 janë rritur për 236,80%, të dalat për pagat e të punësuarve janë rritur për 8,92%, ndërsa edhe të dalat tjera shënojnë ritje, përderisa të dalat e përgjithshme në krahasim me vitin 2007 janë rritur për 244,58%. Nga viti 2006 në pajtim me Ligjin e Sigurimit të Detyrueshëm Pensional me Financim Kapital, në Fond filluan të realizohen të dala në bazë të transferimit të mjeteve në fondet pensionale private për kontributin e sigurimit pensional dhe invalidor, për anëtarët të cilët janë përfshirë në fondet pensionale private. Këto të dala janë rritur prej 1.877,00 milion denarë në vitin 2007,

në 9.233,14 milion denarë në vitin 2021 apo për 491,91%, për shkak numrit të rritur të anëtarëve dhe pagesës së obligimeve të mbetura nga viti i kaluar.

Në grafikun në vijim tregohet lëvizja e të dalave sipas viteve:



3. Rezultate financiare

Në vitin 2021, Fondi realizoi gjithsej të hyra në shumë prej 81.508,27 milionë denarë, ndërsa të dalat e përgjithshme arrijnë 80.147,07 milion denarë dhe realizoi tepriçë të të hyrave mbi të dalat në shumë prej 1.361,20 milion denarë që së bashku me mjetet e bartura nga periudha e kaluar realizoi tepriçë të mjeteve prej 6.285,42 milion denarë. Gjithsej të hyrat në krahasim me vitin 2020, 77.682,64 milion denarë janë më të larta për 4,92%, ndërsa të dalat 77.213,22 milion denarë për 3,88% dhe në krahasim me mjetet e planifikuara, të hyrat janë rritur për 1,06%, ndërsa të dalat lëvizin rreth nivelit të mjeteve të planifikuara me Buxhetin e Fondit për vitin 2021 për 0,63%.

Me të hyrat e realizuara nga kontributet dhe mjetet nga Buxheti i Republikës si dhe nga të dalat tjera, Fondi në vitin 2021 rregullisht e realizonte pagesën e pensioneve në periudhën e caktuar, në javën e parë të muajit për muajin paraprak.

Rezultati financiar i Fondit për vitin 2021 pasqyron një gjendje të mirë funksionimi që rezulton me një rezultat pozitiv financiar nga puna dhe me synime dhe projeksione të mirëpërcaktuara për kryerje të rregullt dhe në kohë të të gjitha obligimeve si në aspektin e mbledhjes së të hyrave ashtu edhe në aspektin e për kryerjen e rregullt të obligimeve në pjesën e ushtrimit të veprimtarisë në të gjitha drejtimet nga realizimi i të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor, si dhe në pjesën e të gjitha obligimeve shtesë që rrjedhin nga kryerja e veprimtarisë së Shërbimit profesional të Fondit, të cilat në tërësi i kreu në vitin aktual.

4. Aksione dhe pjesë

Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë së Veriut posedon aksione dhe pjesë në ndërmarrjet të cilat ishin në pronësi shoqërore dhe u transformuan sipas Ligjit për transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror (në tekstin e më tutjeshëm – LTNKSH).

Në bazë të nenit 193, paragrafi (2) të Ligjit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor përcakton se kapitali total i fituar nga Fondi në bazë të transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqëror nënkupton kapitalin në aksione dhe pjesë në shoqëritë aktive, aksionet dhe pjesët e shitura, si dhe aksionet dhe pjesët në shoqëritë në të cilat është hapur procedurë falimentimi, ose procedurë likuidimi dhe e njëjta ende nuk ka përfunduar. Në kapitalin e përgjithshëm nuk përfshihen aksionet dhe pjesëte shoqërive të likuiduara.

Përfundimisht më 31.12.2020 Fondi posedon aksione në 13 shoqëri aktive aksionare, me gjithsej vlerë nominale të aksioneve prej 18.576.397 EURO apo 12,40% nga kapitali i përgjithshëm i fituar në bazë të LTNKSH-së. Fondi zotëron edhe pjesë në 22 shoqëri aktive me përgjegjësi të kufizuar me gjithsej vlerë nominale të pjesëve prej 470.416 EURO apo 0,31% nga gjithsej kapitali i fituar në bazë të LTNKSH-së. Në 99 shoqëri në të cilat është hapur dhe është në rrjedhë procedura e falimentimit apo e likuidimit, Fondi zotëron aksione dhe pjesë në gjithsej vlerë nominalen prej 53.461.132 EURO apo 35,69% nga gjithsej kapitali i fituar në bazë të LTNKSH-së. Në periudhën e kaluar përfundimisht më 31.12.2021

Fondi ka shitur aksione dhe pjesë të lëshuara prej 519 shoqëri. Gjithsej vlera nominale e aksioneve dhe pjesëve të shitura arrin 77.275.502 EURO apo 51,60% nga gjithsej kapitali i fituar në bazë të LTNKSH-së.

5. Pagesa e kontributeve të mbetura

Gjatë vitit 2021, gjithsej kontributet e mbledhura për sigurim pensional dhe invalidor janë 47.830.830.580,00 denarë, nga të cilat 45.170.870.216,00 denarë janë kontribute nga mbledhja e integruar e pagave të realizuara në vitin 2021, 2.581.849.743,00 denarë janë kontribute në bazë të pagesës së integruar për periudhën 1.1.2009 deri më 31.12.2020, ndërsa 78.110.621,00 denarë janë kontribute të shkaktuara deri më 31.12.2008 për të cilat Fondi është i autorizuar të zhvillojë procedurë të pagesës.

Arsyet për vëllimin e vogël të pagesës së kontributeve të papaguara dhe të mbetura deri më 31.12.2008, për të cilën procedura për pagesë është në kompetencë të Fondit, është në faktin se Fondi, përpos procedurës për pagesë të detyrueshme bllokim i xhirollogarisë të obliguesit, nuk ka mekanizma të tjerë për të paguar kërkesat e saja, të cilën e zotëron Drejtoria e të Hyrave Publike konfiskim të pasurisë. Gjithashtu, arsyeja për vëllimin e vogël të pagesës është fakti që shumë obligues likuidohen dhe fshihen nga Regjistri Qendror, të tjerët shkojnë në falimentim, ndërsa nuk kanë pronë nga e cila mund të paguhen kërkesat, apo nuk kanë xhirollogari ose janë subjekt joaktiv të cilët i kanë çlajmëruar të punësuarit.

Për këta arsye, supozohet që edhe gjatë viteve të ardhëshme do të reduktohet numri i pagesës së kontributeve të cilët janë shkaktuar deri më 31.12.2008, për të cilat procedura për pagesë është në kompetencë të Fondit.

V. REALIZIMI I TË DREJTAVE DHE ZBATIMI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR

1. Raporti për realizimin e të drejtës nga SPI-ja në shkallë të parë

Gjatë vitit 2021 në filialet e Shërbimit profesional të Fondit, u dorëzuan gjithsej 27.366 kërkesa për realizimin e të drejtës nga sigurimi pensional dhe invalidor dhe të bartura 1.668 kërkesa nga viti 2020, gjithsej për zgjidhje kishte 29.034 kërkesa.

Nga gjithsej numri i kërkesave për realizimin e të drejtës së pensionit (së bashku me kërkesat e pazgjidhura nga viti 2020), të zgjidhura janë 27.263 kërkesa apo 93,9%, ndërsa më 31 dhjetor të vitit 2021 mbeten për zgjidhje edhe 1.771 kërkesa apo 6,1% nga gjithsej numri për zgjidhje.

Tabela nr. 16 Pasqyrë e kërkesave të dorëzuara dhe të zgjidhura sipas llojit

Përshkrimi		Kërkesa të pazgjidhura në fillim të vitit	Kërkesa të pranuar gjatë vitit	Gjithsej për zgjidhje	Kërkesa të zgjidhura			
					Gjithsej të zgjidhura	Pjesëmarrje të kërkesave të zgjidhura në raport me gjithsej kërkesat për zgjidhje	Pozitive	Negative
Pensione invalidore	Kërkesa të para	56	1.653	1.709	1.645	96,30%	1.285	360
	Të mbetura	42	761	803	758	94,40%	640	118
Kompensim për dëmtim trupor		5	281	286	281	98,30%	168	113
Kërkesa të mbetura		182	109	291	133	45,70%	103	30
Pension	Kërkesa të para	1.019	15.272	16.291	15.181	93,20%	14.551	630

pleqërie	Të mbetura	35	1.542	1.577	1.542	97,80%	1.433	109
Pension invalidor	Kërkesa të para	328	6.408	6.736	6.397	95,00%	6.174	223
	Të mbetura	1	1.340	1.341	1.326	98,90%	1.156	170
Gjithsej		1.668	27.366	29.034	27.263	93,90%	25.510	1.753

Nga numri i përgjithshëm i kërkesave për zgjidhje sipas gjitha bazave për realizimin e të drejtës nga sigurimi pensional dhe invalidor, 23.333 kërkesa janë kërkesa të para për realizimin e të drejtës së pensionit, prej të cilëve:

- 15.272 kërkesa të para për realizimin e të drejtës së pensionit të pleqërisë,
- 1653 kërkesa të para për të drejtën e pensionit invalidor dhe
- 6.408 kërkesa të para për të drejtën e pensionit familjar.

Struktura e kërkesave sipas llojit të pensionit për të cilën i dedikohen kërkesat është paraqitur në grafikë:



Gjithashtu, u dorëzuan edhe kërkesa të tjera nga sigurimi invalidor, kërkesa të mbetura dhe kërkesa të përsëritura apo gjithsej 4.033 kërkesa të tjera.

Nga gjithsej numri i kërkesave të zgjidhura (27.263) në vitin 2021, në mënyrë pozitive janë zgjidhur 25.510 kërkesa apo 93,6%, ndërsa 1.753 kërkesa apo 6,4% janë zgjidhur negativ.

Tabela nr.17: Kohëzgjatja e procedurës për zgjedhjen e kërkesave të dorëzuara sipas llojit, me gjendje më 31 dhjetor të vitit 2021

Nr.rend.	Përshkrimi		Kërkesa të zgjidhura		Kohëzgjatja e procedurës			
			Gjithsej	Struktura	deri 30 ditë	prej 35-40 ditë	prej 45-50 ditë	prej 2-6 muaj
			1	2	3	4	5	6
1	Pensione invalidor	Kërkesa të para	1.645	6,00%	566	286	626	167
		Të mbetura	758	2,80%	250	291	137	80
2	Kompensim për dëmtim trupor		281	1,00%	192	66	15	8
3	Kërkesa të mbetura		133	0,50%	96	33	4	
4	Pension pleqërie	Kërkesa të para	15.181	55,70%	12657	1133	1378	13
		Të mbetura	1.542	5,70%	1300	129	108	5
5	Pension familjar	Kërkesa të para	6.397	23,50%	5805	232	344	16
		Të mbetura	1.326	4,90%	1161	140	23	2
	Gjithsej		27.263	100,00%	22.027	2.310	2.635	291

Në afat prej 30 ditësh janë zgjidhur 22.027 kërkesa apo 80,8%, prej 30 deri 45 ditë janë zgjidhur 2.310 kërkesa apo 8,5%, në afat prej 45 deri 60 ditë janë zgjidhur 2.635 kërkesa apo 9,7%, ndërsa tek 291 rastet apo 1,0% procedura e zgjidhjes ka zgjatur prej 2-6 muajsh.

Në fund të vitit 2021 mbetën të pazgjidhura 1.771 kërkesa apo 6,0% nga gjithsej numri për zgjidhje (Tabela nr.19), gjegjësisht 109 kërkesa të pazgjidhura për realizimin e pensionit invalidor, 1145 kërkesa për pension pleqërie, 354 kërkesa për pension familjar dhe 163 kërkesa nga sigurimi invalidor dhe kërkesa tjera.

Tabela nr.18: Struktura e kërkesave të zgjidhura dhe të pazgjidhura në gjithsej numrin e kërkesave për zgjidhje me gjendje 31 dhjetor të vitit 2021:

Nr.re.	Përshkrimi		Gjithsej për zgjidhje	Kërkesa të zgjidhura			
				Gjithsej të zgjidhura	Struktura e kërkesave të zgjidhura në gjithsej kërkesa në %	Kërkesa të pazgjidhura 31.12.2021	Struktura e kërkesave të pazgjidhura në gjithsej kërkesa në %
1	2		3	4	5	6	7
1	Pension invalidor	Kërkesa të para	1709	1645	6,00%	64	0,22%
		Të mbetura	803	758	2,80%	45	0,15%
		Gjithsej	2512	2403	8,80%	109	0,38%
2	Pension pleqërie	Kërkesa të para	16291	15181	55,70%	1110	3,82%
		Të mbetura	1577	1542	5,70%	35	0,12%
		Gjithsej pleqërie	17868	16723	61,30%	1145	3,94%
3	Pension	Kërkesa të para	6736	6397	23,50%	339	1,17%

	familjar	Të mbetura	1341	1326	4,90%	15	0,05%
		Gjithsej	8077	7723	28,30%	354	1,22%
4	Kërkesa nga sigurimi invalidor dhe kërkesa të mbetura		577	414	1,50%	163	0,56%
	Gjithsej		29034	27263	100,00%	1771	6,00%

2. Rregullimi ligjor, monitorimi dhe zbatimi i dispozitave juridike dhe të vepruarit sipas parashtresave

Në kuadër të monitorimit dhe zbatimit të dispozitave ligjore, si dhe të vepruarit sipas parashtresave, personat kompetentë në Shërbimin profesional të Fondit gjatë vitit 2021 kanë zbatuar dhe kryer këto aktivitete:

- Përgjigje ndaj 130 parashtresave të dorëzuara nga Kabineti i Kryetarit, Qeveria, Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale dhe ministrinë e tjera, Avokati i Popullit, Inspektorati Administrativ Shtetëror dhe palë të tjera.
- Janë dhënë mendime me sqarime për veprime të mëtutjeshme në 30 raste të parashtruara me pëlqim paraprak nga Filialet e Fondit dhe nga Komisioni për Vlerësimin e Aftësisë për Punë.
- Është përgatitur përgjigje e raportit nga Enti Shtetëror i Revizionit dhe është vepruar sipas vërejtjeve në raport, përkatësisht është përgatitur procedurë për veprim sipas kërkesës për pension invalidor dhe dëmtim trupor.
- Është përgatitur iniciativë për ndryshimin e nenit 141 të Ligjit për SPI-në.
- Është bërë komunikim i përhershëm me shoqëritë private pensionale dhe janë dorëzuar përgjigje për kërkesat e tyre lidhur me anëtarët e shtyllës së dytë.

- Janë përgatitur raporte drejtuar Qeverisë për të vepruarit sipas parashtresave brenda afatit ligjor, për çdo tremujor nga viti 2017.
- Është përgjigjur ndaj pyetjeve të shumta të parashtruara nga personat e siguruar apo nga pensionistë lidhur me të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor.
- Janë përgatitur ndryshimet dhe plotësimet në Rregulloren për organizimin, përbërjen dhe mënyrën e punës së Komisionit për Vlerësimin e Aftësisë për Punë.
- Pas miratimit të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Punëve të Brendshme dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Mbrojtjes dhe Shpëtimit, është përgatitur Udhëzim për veprim sipas tyre.
- Është përgatitur udhëzim për paraqitjen e kërkesës për pension pleqërie në formë elektronike dhe udhëzim teknik për zbatimin e aplikimit. Është marrë pjesëmarrja në grupet punuese dhe komisionet e Ministrisë së Punës dhe të Politikës Sociale dhe institucioneve të tjera përkatëse.
- Janë mbajtur trajnime për të punësuarit, përgjegjës për zgjidhjen e të drejtave të shkallës së parë në fillialin e Shkupit.

3. Realizimi i të drejtave të SPI-së sipas marrëveshjeve të BE-së dhe marrëveshjeve ndërkombëtare

Në vitin 2021 Fondi i SPIMV-së vazhdoi të kryejë punët rrjedhëse si bartës i sigurimit dhe organ për lidhje, kompetent për realizimin e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor sipas dispozitave të Bashkësisë Europiane dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për sigurim social.

Në kuadër të zbatimit të drejtëpërdrejtë të marrëveshjeve për sigurim social Shërbimit profesional i Fondit në periudhën prej 1.1.2021 deri më 31.12.2021 ka realizuar punët në vijim:

Bisedime në nivel të organit për lidhje

- prej 1 deri 3 qershor të vitit 2021 nëpërmjet video konferencës u mbajtën bisedime në nivel të organeve për lidhje ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Turqisë në të cilën u shqyrtuan dhe harmonizuan propozim ndryshimet e formularëve dy gjuhësore për ndryshimin e marrëveshjes bilaterale për sigurim social.

- në periudhën nga janari deri në dhjetor të vitit 2021 nga të siguruarit apo nëpërmjet bartësit të huaj të sigurimit janë pranuar 4.411 kërkesa (kërkesë për përsëritje të procedurës, vendime të refuzuara për pension familjar dhe vendime të refuzuara me shumë të ulët të pensionit, si dhe kërkesa për vërtetimin e stazhit), e cila në krahasim me vitin e kaluar paraqet rritje prej 138,82%.

- nga gjithsej numri i kërkesave të pazgjidhura, të zgjidhura dhe kontrolluara janë 3.192 kërkesa, përkatësisht për 75,67% më shumë në krahasim me vitin 2020.

Deri te bartësi i huaj i sigurimit, te formularët dygjuhësorë janë përpunuar dhe dorëzuar 1.811 kërkesa për pensione.

- pas dorëzimit të kërkesave për realizimin e të drejtës, janë bërë 5.665 korrespondenca me palët, me njësitë rajonale dhe me mbajtësit e huaj, me qëllim që kërkesat të kompletohen dhe me këtë të realizohen realizohen më shpejt të drejtat e pensionit.

- është inicuar procedurë për 747 kërkesa për përcaktimin e stazhit pensional i kryer jashtë Republikës për personat e siguruar të cilët nuk realizojnë të drejtën e pensionit dhe reciprokisht për nevojat e mbajtësve të huaj dhe nevojat tona.

- në Komisionin invalidor të shkallës së parë për vlerësimin e aftësisë për punë janë dhënë 142 lëndë,

- në periudhën raportuese ka arritur një numër të madh të parashtrësive dhe për të cilët është dhënë përgjigje.

Nr.rendor	Përshkrimi	Viti 2021	Viti 2020	Indeks 2020/2021
1	Kërkesa të bartura	592	562	
2	Kërkesa të pranuar	4.411	1.847	41,9
3	Gjithsej kërkesa	5.003	2.409	48,2
4	Kërkesa të zgjidhura	3.192	1.817	56,9
5	Kërkesa të pazgjidhura	1.811	592	

4. Komisioni për vlerësimin e aftësisë për punë

Për realizimin e të drejtës nga sigurimi pensional dhe invalidor rëndësi të madhe ka vlerësimi i aftësisë për punë të të siguruarit, sepse, nëse ekziston invaliditet apo dëmtim trupor, i siguruari realizon edhe të drejtat materiale afatgjate nga sigurimi pensional dhe invalidor.

Ndryshimet e përhershme në gjendjen shëndetësore nga lëndimi në punë, jashtë pune apo sëmundja profesionale, të cilat nuk mund të mënjanojnë me shërim apo me masa të rehabilitimit mjekësor dhe ka pasuar ulje apo humbje të aftësisë së punës për të kryer detyrat në vendin e punës ku punonjësi ka qenë i sistemuar, konsiderohen për invaliditet.

Me hyrjen e ligjit të ri në fuqi për sigurim pensional dhe invalidor prej 1.8.2012, përveç përcaktimit të invaliditetit sipas kategorive dhe të shprehur në përqindje, përcaktohet edhe invaliditet nëse aftësia e punës e të siguruarit është zvogëluar për 50% dhe ai mund të punojë me orar të shkurtër të punës, ose të sistemohet në detyra përkatëse të punës në përputhje me rregulloret të cilat zbatohen nga marrëdhëniet e punës dhe marrëveshjes kolektive.

Komisioni për vlerësimin e aftësisë për punë pranë Fondit, e përcakton invaliditetin si bazë për realizimin e të drejtës nga sigurimi pensional dhe invalidor, pas një kontrollit të kryer në dokumentacionin mjekësor dhe të punës dhe një kontroll të kryer të të siguruarit.

Punët për të cilat vlerësohet aftësia e punës e të siguruarit, i përfshijnë punët e aftësisë së tij trupore dhe psikike, ndërsa konsiderohen se u përgjigjen punëve të tij të deritanishme, përderisa vlerësimi i aftësisë së punës së bujkut individual përfshin punën në bazë të sigurimit të detyrueshëm, në mbështetje të këtij ligji.

Në vitin 2021, Komisioni për vlerësimin e aftësisë për punë punonte në 2 përbërje me nga 2 anëtarë - mjekë specialistë dhe 1 mjek specialist - udhëheqës, me çka rregullisht dhe në kohë janë kryer obligimet dhe është sjellë konstatim, vlerësim dhe mendim edhe në lëndët tek të cilat zbatohet Marrëveshja bilaterale për sigurim social.

Në vitin 2021, në arkivin e Komisionit të shkallës së parë për vlerësimin e aftësisë së punës janë pranuar dhe verifikuar 4.087 lëndë, përderisa në vitin 2020 janë pranuar 3.090 lëndë, apo 997 lëndë më shumë, apo 32,3% dhe ato lëndë janë kompletuar.

Pasqyrë e detajuar e lëndëve të përpunuara në vitin 2021:

- Lëndë të regjistruara dhe të pranuar	4.087
- Lëndë të regjistruara nga viti 2021	3.685
- Lëndë të mbetura	402
- Lëndë të zgjidhura me konstatim të sjellë	3.984
- Procedurë e ndërprerë për shkak të vdekjes	31
- Procedurë e ndërprerë sipas nenit 14 dhe Të kthyer në NJR-në në procedurë për realizim	72
- Gjithsej kërkesa të regjistruara për NGM-në	1.820
- Kërkesa të regjistruara në vitin 2020	789
- Lëndë të mbetura dhe të bartura nga viti 2021	1.031
- Lëndë të zgjidhura me konstatim të sjellë	1.137


Nevojitet të nënvizohet se nga muaji tetor i vitit 2019 në mbështetje të Ligjit të SPIMV-së Komisioni i VAP-së filloi me zgjidhjen e të drejtës së ndihmës minimale të garantuar.

Struktura dhe lloji i kërkesave të ekspertuara në vitin 2021:

Tabela nr.20: Kërkesat e zgjidhura për vlerësimin e aftësisë për punë sipas llojeve në vitin 2021 dhe 2020 janë dhënë në tabelën vijuese:

Nr. rendor	Lloji i rasteve	Viti 2021		Viti 2020		Indeks
		Numri	Struktura	Numri	Struktura	2021/2020
1	Paaftësi e përgjithshme për punë	1102	32,1	593	30,9	185,8
2	Orar i shkurtuar i punës	623	18,2	473	24,7	131,7
3	Ndryshimi i punës	87	2,5	72	3,8	120,8
4	Zvogëlim edhe më tej i aftësisë për punë	122	3,6	116	6,0	105,2
5	Mjekimi nuk ka përfunduar	0	0	0	0	0,0
6	Nuk ekziston invaliditet	1135	33,1	479	25,0	237
7	Raste të tjera	0	0,0	0	0	0
8	Kontrolle të sërishme	142	4,1	96	5,0	147,9
9	Pension familjar	179	5,2	58	3,0	308,6
10	Konstatime për bartësit e huaj	41	1,2	31	1,6	132,3
	GJITHSEJ I	3431	100,0	1918	100	178,9
1	Mbrojtje mjekësore	0	0	0	0	0,0
2	Dëmtim trupor	553	100,0	393	100,0	140,7
3	Kontroll mjekësor	0	0	0	0,0	0
	GJITHSEJ II	553	100	393	100	140,7
	GJITHSEJ (I+II)	3.984	100	2.311	100	172,39

Struktura e kërkesave të ekspertuara mund të shihet në grafikun e mëposhtëm:



Nga të dhënat në tabelë për kërkesat e zgjidhura nga ana e Komisionit për vlerësimin e aftësisë për punë në vitin 2021, është e qartë se, puna zhvillohej në kohë të duhur, ndërsa lëndët në një afat më të shkurtër kohor janë zgjidhur në 97,5% kërkesa të zgjidhura në raport të gjithsej kërkesave të parashtruara, gjegjësisht kërkesave të kompletuara.

Tabela nr. 21. Numri i konstatimeve të sjella për vlerësimin e aftësisë për punë sipas viteve paraqitet në vazhdim:

Viti	Vlerësimi i aftësisë për punë	Dëmtimi trupor	Kërkesa të tjera	Gjithsej
2007	7.397	345	963	8.705
2008	6.605	297	1.689	8.591
2009	6.221	358	1.069	7.648
2010	4.479	254	1.110	5.843
2011	3.225	201	561	3.987
2012	5.131	401	959	6.491
2013	4.678	415	833	5.926
2014	3.776	373	911	5.060
2015	3.605	340	878	4.823
2016	3.601	324	660	4.585
2017	3.368	275	488	4.131
2018	3410	328	379	4.117
2019	2.973	455	33	3.461
2020	1.917	393	49	2.359
2021	3.390	553	41	3.984

Sipas të dhënave në tabelë del se në vitin 2020 ka reduktim të konstatimeve të sjella për vlerësimin e aftësisë për punë në raport të vitit paraprak.

Revizion për të gjitha konstatimet e Komisionit për vlerësimin e aftësisë për punë me të cilat është përcaktuar invaliditetet, gjegjësisht paaftësi për punë si dhe në bazë të

zgjidhjes së rastësishme dhe revizion në konstatimet negative, kryen Komisioni për revizion të konstatimit, vlerësimit dhe mendimit për përcaktimin e invaliditetit, gjegjësisht paaftësisë për punë i themeluar nga ministri i Punës dhe i Politikës Sociale.

Në vitin 2021, Komisioni për vlerësimin e aftësisë për punë i ka dorëzuar Komisionit për revizion, të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale gjithsej 1658 konstatime (1295 pozitive dhe 36 negative).

Prej 1295 konstatimeve të dorëzuara pozitive, Komisioni për revizion përcaktoi 1243 apo 95,9% nga gjithsej numri i konstatimeve, ndërsa nuk ka konfirmuar 52 konstatime apo 4,1%.

Gjithashtu, prej 361 konstatimeve të dorëzuara negative në Komisionin për revizion pranë Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, e njehta konfirmoi 318 konstatime, apo 87,6%, ndërsa nuk ka konfirmuar 45 konstatime apo 12,4%.

Gjithsej numri i konstatimeve të parashtruara nga VAP-ja deri te MPPS-ja janë regjistruar të gjitha konstatimet e sjella nga procedura e shkallës së parë.

Gjendja e lartpërmendur ka të bëjë me zbatimin e rreptë të rregulloreve për punën e Komisionit të revizionit pranë MPPS-së, i cili ka vepruar dhe zbatuar në mënyrë rigoroze dispozitën për të kontrolluar lëndët me konstatim të sjellë negativ sipas zgjedhjes së rastësishme dhe jo sikurse në periudhën e kaluar kur kërkoheshin të gjitha lëndët për revizion.

5. Evidentimi i amzës

Shërbimi profesional i Fondit, në kuadër të evidentimit amë i zbatonte aktivitetet në vijim:

- Dhënie e mendimit për veprim sipas lëndëve të dorëzuara nga ana e Filialeve/Ekspoziturave

- Përgjigje ndaj pyetjeve dhe përgjigje me shkrim të dorëzuara nga të siguruarit, obliguesit dhe institucionet
- Përgatitjen dhe dhënien e lajmërimeve të filialeve/ekspoziturave si dhe udhëzimet për punë
- Dhënien e përgjigjeve të të siguruarve për të cilët stazhi i sigurimit llogaritet me kohëzgjatje të shtuar.
- Pjesëmarrje në Projektin për administrimin e sigurimit social SIAN për evaulimin e portfolios për revizion të stafit të sigurimit, i cili llogaritet me kohëzgjatje të shtuar.
- Bashkëpunimi i Fondit me udhëheqësit e filialeve/ekspoziturave, institucionet në raport të anëtarësimit në shtyllën pensionale private dhe përgjigje ndaj kërkesave për anëtarët në fondet pensionale private.
- Përgatitje të propozim ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjit të sigurimit pensional dhe invalidor.
- Përgjigje ndaj pyetjeve , dhënie të mendimeve në mbështetje të Ligjit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale
- Veprim sipas kërkesave për monitorimin dhe sigurimin e korrespondencave nga origjinali i fletëparaqitjeve të mikrofilmuara.
- Bashkëpunim me Regjistrin Qendror në raport të dërgimit të e-mail adresave për obliguesit
- Përgatitje të kërkesave afariste deri tek Sektori i TI-së për zbatimin e korigjimeve në pjesën e gjenerimit të të dhënave sipas kontributit të paguar për sigurim pensional dhe invalidor
- Përgatitje të kërkesës deri tek Sektori i TI-së për përgatitjen dhe dorëzimin e pasqyrave me të dhënat e punonjësve tek obliguesit
- Përgatitja e procedurave për punë

Gjithashtu në vitin 2021 nga ana e filialeve dhe ekspoziturave të Fondit u ndërmorrën aktivitete për grumbullimin e fletëparaqitjeve M/4, për periudhën deri 31.12.2005.

Në raport të regjistrimit interaktiv të të dhënave për stazhin e sigurimit dhe pagat (M/4), në sistemin e përpunimit automatik të të dhënave, është evidentuar se, gjatë vitit 2021 në evidencën elektronike të Fondit janë regjistruar 56.935 fletëparaqitje.

Në raport të të dhënave të gjeneruara gjatë vitit 2021 janë gjeneruar 227.362 fletëparaqitje.

Gjithsej M/4 fletëparaqitje të regjistruara dhe të gjeneruara për vitin 2021 janë 284.297 fletëparaqitje.

Sikurse në raportet e mëparshme ashtu edhe gjatë vitit 2021 Fondi ballafaqohet me një problem të M4 fletëparaqitjeve jo të grumbulluara për vitet e kaluara si rezultat i asaj se një numër më i madh i subjekteve afariste nuk ekzistojnë më dhe nuk shoqërohen ndaj obligimit ligjor që dokumentacionin t'ia dorëzojnë Arkivit të RMV-së.

6. Pagesa e pensioneve

Një nga funksionet kryesore të Fondit në zbatimin e sigurimit pensional dhe invalidor është pagesa e përfitimeve pensionale të përfituesve të pensionit. Gjatë vitit 2021, në bashkëpunim me Sektorin e TI-së kryhej rregullisht përpunimi dhe pagesa e rregullt e pensioneve. Më konkretisht gjatë vitit të kaluar kryhej:

- Përgatitja dhe pagesa e rregullt mujore e pensioneve për përfituesit e pensioneve nga sigurimi i punës, pensionet ushtarake, pensionet minimale bujqësore si dhe pagesa në ish-republikat Jugosllave dhe transfere.
- Përgatitja dhe pagesa e jashtëzakonshme për përfituesit e ndjerë të pensionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe vendet e huaja.
- Përpunimi, shtypja, kontrollimi dhe hapja e dosjeve financiare për aktvendime të reja që janë sjell për përfituesit e pensionit të cilët për herë të parë kanë fituar të drejtën e pensionit.

- Përpunimi, shtypja, kontrollimi i aktvendimeve të sjella nga ana e filialeve të Fondit për ripërtëritjen e procedurës, aktvendime ndërprerëse etj.
- Të vepruarit sipas aktvendimeve, përlllogaritja dhe kontrolli i tyre.
- Pranimi, evidentimi, skanimi dhe të vepruarit sipas kërkesave për informacion, njoftime dhe urdhëresa për ekzekutim, të dorëzuara nga përmbaruesit.
- Vërtetime të pranuar dhe të përpunuara të jetës në muajin mars dhe nëntor të vitit 2021 për përfituesit e pensionit të cilëve pagesa u bëhet në ish-republikat Jugosllave, transferim edhe për përfituesit e pensionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për të cilët pagesa bëhet nëpërmjet një personi të autorizuar, përfitues të pensionit në bazë të paaftësisë për punë dhe jetë të pavarur si dhe kategori tjera të përfituesve të pensionit.
- Përrjashtim nga pagesa për përfituesit e pensionit, të cilët me kërkesë të Fondit në afatin e përcaktuar nuk kanë dorëzuar vërtetim të jetës në muajin maj dhe dhjetor të vitit 2021.
- Parashtrim i njoftimit mbi ndërprerjen e të drejtës së pagesës për përfituesit e pensionit të cilët edhe pas dorëzimit të dytë nuk kanë dërguar Vërtetim të jetës.
- Pranimi, skanimi dhe përpunimi i formularit për kërkesat e dëmtuara në mbështetje të marrëveshjeve me ish-republikat jugosllave.
- Shkëmbimi elektronik i përfituesve të ndjerë të pensionit të cilët kanë jetuar në ish-republikat jugosllave, pasivizim, kërkesë e më tepër përfitimeve pensionale të paguara nga banka.
- Pranimi, skanimi dhe evidentimi i vërtetimeve shkollore gjatë muajit tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2021 për përfituesit të cilët shfrytëzojnë të drejtën e pensionit në bazë të shkollimit.
- Pasivizimi i pagesës për përfituesit në bazë të shkollimit të cilët kanë mbushur moshën 15 vjeç, ndërsa ata nuk kanë dorëzuar vërtetim për shkollim.
- Llogaritja, përgatitja dhe dorëzimi i përlllogarive për pagesat e bëra në Seksionin e çështjeve juridike.

- Kontrolli i rritur i aktvendimeve të reja që mbërrijnë çdo ditë në seksion, me çka në rastet ku janë përcaktuar mangësi, aktvendimet janë kthyer në filialet e Fondit për korrigjim.

7. Zbatimi i kompetencave nga shtylla e dytë pensionale

Në evidencën e Fondit të SPIMV-së përfundimisht në dhjetor të vitit 2021 janë regjistruar 372.752 të siguruar aktivë, anëtarë në shtyllën e dytë pensionale.

- Gjatë vitit 2021, Shërbimi profesional i Fondit në kuadër të kompetencave dhe detyrave të lidhura me shtyllën e dytë realizuan aktivitete të shumta ndër tjerash:
- Ishin përpunuar procedura afariste për realizimin e kompetencave në fondin e dytë pensional,
- Është monitoruar validizimi i fletëparaqitjeve M1/2 dhe M11, me qëllim të realizimit të procedurës së pandërprerë për regjistrimin e anëtarëve në shtyllën e dytë pensionale,
- Janë dhënë të dhëna të sakta dhe të kompletuara për të siguarit, anëtarë në shtyllën e dytë,
- U përgatitën raporte mujore drejtuar Ministrisë së Punës dhe të Politikës Sociale dhe realizohej bashkëpunim i rregullt me Agjencinë e Mbikqyrjs MAPAS.

Gjatë vitit 2021 Fondi vazhdoi të paguajë kompensimin për funksionet të cilat i kryente për nevojat sigurimit të detyrueshëm pensional me financim kapital. Kompensimi paraqet kompensim mujor në barë të shoqërive pensionale në lartësi prej 0,1% nga çdo kontribut i paguar për muajin e kaluar në fondet pensionale me të cilat menaxhojnë shoqëritë.

VI. ORGANET E MENAXHIMIT TË FONDIT

1. *Këshilli Drejtues*

Këshilli Drejtues i Fondit të SPIMV-së si organ më i lartë i menaxhimit, edhe në vitin 2021 aktivitetin e tij e kahëzoi për sigurimin e mjeteve për zbatimin e sigurimit pensional dhe invalidor dhe ruajtjen e sigurisë materiale dhe sociale të përfituesve të pensionit si dhe në interes dhe përmirësim të politikës pensionale në vendin tonë.

Këshilli drejtues i Fondit është i përbërë nga shtatë anëtarë të emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë në afat prej katër viteve. Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve, pesë anëtarë, gjegjësisht nga një përfaqësues emërohen në propozim të: Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Ministrisë së Financave, Sindikatës Përfaqësuese, anëtare e Këshillit Ekonomik Social, Shoqatës Përfaqësuese të Punëdhënësve, anëtare e Këshillit Ekonomik Social dhe Lidhjes së Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë së Veriut. Këshilli Drejtues i Fondit nga radhët e tij zgjedh kryetar dhe nënkryetar me kohëzgjatje prej një viti dhe për punën e tij, së paku një herë në vit i dorëzon raport Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Këshilli drejtues i Fondit në punën e tij miraton program dhe plan për punë, përcakton propozim - kërkesë buxhetore deri te Ministria e Financave, miraton llogarinë përfundimtare të Fondit, kujdeset për pagesën e rregullt të kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor, vendos për shfrytëzimin e mjeteve të Fondit, për shitjen e pronës në pronësi të Fondit, për shitjen e aksioneve dhe pjesëve nga gjithsej kapitali i arritur në bazë të transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqëror, kujdeset dhe rregullisht ndjek pagesën e ndihmës së pasvdekjes së përfituesve të pensionit dhe të mjeteve të ndara nga pensionet për anëtarësim si dhe i shqyrton çështjet, raportet, informacionet dhe materialet e tjera në lidhje me gjendjen dhe problemet nga sigurimi pensional dhe invalidor dhe punë të tjera në kompetencë të Fondit.

Këshilli drejtues i Fondit të SPIMV-së, në vitin 2021 punën e tij e realizoi në mbështetje të dispozitave statutore dhe Programit dhe planit për punën e Këshillit Drejtues për vitin 2021, me çka mbajti 13 seanca, në të cilat u shqyrtuan, u diskutuan gjithsej 73 materiale. Janë sjellë 34 vendime, 5 rregullore, si dhe Programi dhe plani për

punën e KD –së së Fondit të SPIMV-së dhe Plani vjetor për punën e Fondit të SPIMV-së, u miratuan 23 informacione dhe 3 raporte, ndërsa u soll edhe Propozim kërkesa e buxhetit të Fondit të SPIMV-së për vitin 2022 dhe Plani strategjik i Fondit të SPIMV-së për periudhën prej vitit 2022 – 2024.

Anëtarët e Këshillit Drejtues kishin bashkëpunim dhe përgjegjësi kolektive dhe cilësore në marrjen e vendimeve dhe konkluzioneve, në interes të shfrytëzuesve të shërbimeve tona.

Këshilli Drejtues i Fondit ka kryer një aktivitet jashtëzakonisht të rëndësishëm pune-udhëheqjeje, që paraqet një legjitimitet të vërtetë që Fondi në vitin 2021 me përgjegjësi, cilësi dhe në kohë realizon Programin dhe planin e punës, me respektim konsekuent me dokumentet ligjore: Ligjin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor, Statutin e Fondit të SPIMV-së dhe Rregulloren e punës së Këshillit Drejtues.

Gjithashtu, për Arkivin Shtetëror të Republikës së Maqedonisë së Veriut është bërë përshkrim dhe regjistrim i lëndës arkivore me vlerë të përhershme, në të cilën përmbahen të gjitha seancat e mbajtura të Këshillit Drejtues të Fondit dhe janë nënvizuar dokumentet e miratuara në seancat e mbajtura në vitin 2021.

2. Drejtori

Drejtori i Fondit e udhëheq Fondin dhe e përfaqëson atë para personave të tretë. Në kuadër të autorizimeve të tij në vitin 2021, drejtori me sukses e ka udhëhequr punën dhe funksionimin e institucionit, gjë e cila kontribuoi në realizimin e plotë të Programit për punën e Fondit dhe të realizohen rezultate pozitive në të gjitha segmentet e zbatimit të sigurimit pensional dhe invalidor. Ai gjithashtu, ka ndërmarrë më shumë masa për pagesën e kontributit të papaguar përfundimisht me vitin 2008, ndaj rritjes së pagesës së kontributit për sigurim pensional dhe invalidor, ndaj përmirësimit të punës financiare të Fondit, ndërsa me qëllim të avancimit të punës së Fondit u ndërmorr iniciativë para ministrive kompetente dhe institucioneve në drejtim të ndryshimit të rregullores ligjore të përhershme.

Si organ ekzekutiv, drejtori i Fondit gjatë vitit 2021 Këshillit Drejtues i dorëzoi, raporte, analiza, propozim vendime, ndërsa njëkohësisht kujdesej edhe për zbatimin e vendimeve dhe konkluzioneve të sjella nga ana e Këshillit Drejtues të Fondit dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nga aspekti i funksionimit të shërbimit profesional të Fondit, drejtori organizon dhe koordinon punën e tyre, ndërmerr masa dhe aktivitete për plotësimin e vendeve të lira të punës me të punësuar të rinj dhe vendos për realizimin e të drejtave të tyre nga marrëdhënia e punës.

VII. Shërbimi profesional i Fondit

1. Seksioni për revizion të brendshëm

Seksioni për revizion të brendshëm gjatë vitit 2021 i kryente detyrat e rregullta të punës të paraparë në Planin strategjik për kryerjen e revizionit prej vitit 2021 – 2023 dhe Planin vjetor për revizion për vitin 2021 me qëllim që nëpërmjet konstatimeve, rekomandimeve, vërejtjeve dhe rolit këshillues të tij të kontribuon në përmirësimin e punës dhe rritjen e efikasitetit të sistemeve për kontrollin e brendshëm.

Revizioni i brendshëm kryen detyrat e tij të punës në mbështetje me standardet e pranuarra për zbatimin profesional të revizionit, Ligjin e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, aktet nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji, Dokumentit për revizion të brendshëm si dhe Kodeksit etik të revizorëve të brendshëm.

Për çdo revizion të zbatuar përgatitet dokumentacion i plotë që paraqet dosje të revizionit, i cili është i selektuar dhe renditur sipas numrit, për shkak të organizimit në ekzekutim.

Përveç revizioneve të zbatuara, Seksioni për revizion të brendshëm gjatë vitit 2020 i kryente edhe aktivitetet në vijim:

- Përgatitje të deklaratës mbi cilësinë e gjendjes për kontrollet e brendshme për vitin 2021, në mbështetje të Ligjit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 90/09, 188/13 dhe 192/15).
- Përgatitje të Planit vjetor për vitin 2022 dhe Planit strategjik për vitin 2022-2024 për punën e Seksionit për revizion të brendshëm i cili është miratuar nga u.d. drejtori i Fondit të SPIMV-së dhe i është dorëzuar Ministrisë së Financave.
- Në mbështetje me standardet ndërkombëtare për kryerjen e revizionit të brendshëm, Seksioni për revizion të brendshëm ka përgatitur një Regjistër të rekomandimeve i cili azhurnohet rregullisht pas raporteve të dhëna ose rekomandimeve të zbatuara. Regjistri i përditësuar i rekomandimeve prej 10.1.2022 përmban shtatëmbëdhjetë (17) raporte përfundimtare nga revizioni i brendshëm dhe janë përfshirë një qind e gjashtëdhjetë e katër (164) rekomandime gjatë kohës së revidimit të tyre. Regjistri i përditësuar i rekomandimeve prej 10.1.2022 ka përfshirë periudhën e revizioneve të kryera nga viti 2019, 2020 dhe 2021, në të janë vendosur konstatimet dhe rekomandimet nga proceset të cilat duhet përmirësuar.
- Regjistri i rreziqeve përditësohet së paku një herë në vit me vlerësimin e vet të rreziqeve që kërcënojnë punën e Fondit të SPIMV-së. Regjistri i rreziqeve përmban 143 rreziqe të vlerësuara nga katër sektorë në Fondin e SPIMV-së, vlerësimet janë bërë në bazë të revizioneve që janë zbatuar në periudhën e kaluar ose sipas procedurave për punën e seksionit.
- Gjatë vitit 2021 është përditësuar Universumi i revizionit i cili është dokument përbërës i Planit strategjik të Seksionit për revizion të brendshëm për periudhën prej vitit 2022 – 2024. Ky dokument shfrytëzohet për vlerësimin e rreziqeve gjatë planifikimit të revizioneve. Universi i revizionit i definon proceset kryesore dhe objektivat e atyre proceseve me qëllim që t'i vlerësojë me faktorët e rrezikut.
- Në periudhën prej 01.01.2021 deri më 31.12.2021 janë zbatuar revizione në mbështetje të Planit vjetor për vitin 2021, si dhe rreziqe të jashtëzakonshme me kërkesë të Drejtorit të Fondit. Gjatë vitit 2022 është paraparë zbatimi i revizionit *follow up* për zbatimin e

rekomandimeve, veçmas për çdo revizion të kryer në mbështetje të planit për zbatimin e rekomandimeve.

Në vazhdim vijon pasqyrë e revizioneve të zbatuara për periudhën prej 1.1.2021 deri më 31.12.2021.

- Revizion i jashtëzakonshëm i sistemit të kontrolleve të brendshme të procesit për evidentim amë për përcaktimin e stazhit në filialin e Fondit në Koçan.
- Revizion i procesit të pagesës së të ardhurave nga pensionet në Sektorin për çështje financiare në Fond.
- Revizioni (follow up) i veprimit sipas konstatimeve dhe rekomandimeve nga revizionet e kryera për periudhën prej datës 1.1.2020 deri më 31.12.2021 në Fond.
- Revizion i çrregullt i sistemit të kontrolleve të brendshme të procesit të pagesës së fondit solidar për trashëgimtarët e përfituesit të pensionit në Fond.
- Revizion i sistemit të kontrolleve të brendshme të procesit të menaxhimit, sigurisë dhe sigurisë së pronës së FSPIMV-së
- Revizion i sistemit të kontrolleve të brendshme të procesit të realizimit të së drejtës për pension invalidor me kontroll të detyrueshme në Fond.
- Revizion i çrregullt i përputhshmërisë së procesit në evidencën amë gjatë përcaktimit të stazhit të sigurimit dhe përputhshmërisë së vendimeve të miratuara për realizimin e të drejtave nga SPI-ja, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në Fond.
- Revizion i procesit për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemit informativ në FSPIMV.

2. Koordinimi i buxhetit

Shërbimi profesional i Fondit përgatit plane dhe programe planifikuese-analitike, analiza statistikore, rishikime dhe një mori informacionesh në kuadër të monitorimit aktual të sistemit të sigurimit pensional dhe invalidor, si dhe për zhvillimin e planifikuar të tij.

Buxheti i Fondit është pjesë përbërëse e buxhetit të shtetit. Shërbimi profesional i Fondit në koordinim me ministrinë dhe institucionet kompetente përgatit projektbuxhetin e Fondit, monitoron dhe analizon realizimin e të hyrave dhe të dalave buxhetore dhe përgatit propozime për ndryshimin dhe plotësimin e buxhetit. Monitoron, analizon dhe jep mendim për aktet e përgatitura nga njësitë e tjera organizative të Fondit që kanë implikime financiare për buxhetin.

Gjatë vitit 2021, të gjitha aktivitetet e mësipërme u kryen me sukses nga autoritetet në Shërbimin profesional. Është përgatitur raporti vjetor për punën e Fondit në vitin 2020, janë përgatitur analiza ditore, mujore, tremujore dhe periodike dhe janë dorëzuar deri te Qeveria, Këshilli Drejtues i Fondit dhe deri te ministrinë dhe institucionet kompetente, janë mbledhur të dhëna statistikore në lidhje me të siguruarit dhe përfituesit e të drejtave nga SPI-ja, janë analizuar tendencat statistikore dhe janë përgatitur dhe dorëzuar rregullisht raporte të rregullta statistikore. Është përgatitur Propozimplanit strategjik i Fondit për periudhën 2022 - 2024 dhe ai është miratuar nga Këshilli Drejtues.

Për sa i përket shumës së pensioneve, Shërbimi profesional në vitin 2021, bazuar në të dhënat zyrtare për shpenzimet e jetesës, dy here përcaktoi përqindjet e harmonizimit të pensioneve.

3. Kontrolli i buxhetit

Gjatë vitit 2021, Seksioni për kontrollin e buxhetit të Fondit ka zbatuar plotësisht të gjitha detyrat e parapara me programin e punës dhe me planin për kryerjen e kontrolleve financiare në FSPIMV-në. Është bërë rregullisht kontrolli ex-ante dhe ex-post i të gjitha marrëveshjeve financiare të Fondit të lidhura me institucionet tjera dhe është monitoruar zbatimi i tyre, si dhe kontrolli i të gjitha faturave në hyrje. Rregullisht është monitoruar realizimi i buxhetit dhe informimi drejtorit të Sektorit të çështjeve financiare për atë. Është siguruar shpërndarja e brendshme e buxhetit sipas LKMPF-së. Është kryer kontrolli i rregullt i fletëurdhësive për udhëtim dhe i faturave fiskale për karburantet, si dhe kontrollim financiar i mjeteve të miratuara në buxhetin për furnizime publike. Shërbimi

profesional i Fondit gjatë vitit 2021 ka marrë pjesë aktive në komisionet për regjistrimin e pronës së Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut. Gjatë vitit 2021, Seksioni për kontrollin e buxhetit, me rekomandim të Entit Shtetëror të Revizionit, ka përgatitur një propozim procedurë si ndryshim i procedurës ekzistuese për mënyrën e kryerjes së shpërndarjes së brendshme të buxhetit të përgjithshëm të miratuar, marrjen e detyrimeve financiare dhe kryerjen e pagesave në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut, e cila do të rishikohet gjatë vitit 2022. Gjithashtu, me rekomandim të revizionit janë përgatitur kërkesat për pagesa dhe lista kontrolluese, të cilat do të përfshijnë faturat për shpenzimet e rregullta të përgjithshme, procesin e pagave të të punësuarve si dhe kompensimet e personave të punësuar nga jashtë. Në bazë të këtyre formularëve, gjatë vitit 2022 pritet të përgatiten edhe procedura përkatëse. Shërbimi profesional i Fondit zbaton në mënyrë aktive rekomandimet për ndjekjen e procedurave me shkrim nga të gjitha anët e të gjithë personave kompetentë në sektorë dhe seksione dhe ato të azhurnohen sipas ndryshimeve dhe risive në funksionim. Gjithashtu siguron respektimin e plotë të Rregullores mbi mënyrën e kryerjes së shpërndarjes së brendshme të buxhetit të përgjithshëm të miratuar, marrjen e obligimeve financiare dhe kryerjen e pagesave në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut.

4. Furnizimet publike

Seksioni i furnizimeve publike në vitin 2021 zbatoi procedurat për furnizim sipas Planin vjetor për furnizime publike të Fondit në vitin 2021 dhe ndryshimin dhe plotësimin e Planit vjetor për furnizime publike, sipas Ligjit të furnizimeve publike me shfrytëzimin e sistemit elektronik për furnizime publike SEFP (<https://e-nabavki.gov.mk>),

Në vitin 2021 janë publikuar gjithsej 56 shpallje për ndarjen e marrëveshjeve për furnizime publike dhe 2 shpallje më shumë nga viti i kaluar 2020.

Tabela nr.22 Pasqyrë e numrit të shpalljeve të publikuara sipas llojit të procedurës

Lloji i procedurës	Numri i shpalljeve
Furnizim me vlerë të vogël	14
Procedurë e thjeshtë e hapur	32
Procedurë e hapur	8
Furnizim i shërbimeve speciale	2
Gjithsej	56

Sipas të dhënave në Tabelën nr.22 më shumë shpallje të kontratave janë publikuar me procedurë të hapur të thjeshtuar dhe furnizim me vlerë të vogël. Kështu, 16 shpallje janë publikuar për furnizime publike të mallrave, 37 shpallje për furnizimin e shërbimeve dhe 3 shpallje u shpallën për furnizim të punëve.

Fondi i SPIMV-së si organ kontraktues në vitin 2021 ka lidhur gjithsej 63 kontrata për furnizime publike të cilat i dedikohen lëndëve të ndashme të furnizimit nga procedurat e zbatuara edhe atë 9 kontrata me procedurë të hapur, 36 kontrata me procedurë të hapur të thjeshtuar, 17 kontrata me furnizim të vlerës së vogël dhe 1 kontratë për furnizimin e shërbimeve të veçanta.

Të gjitha të dhënat në lidhje me kontratat e lidhura dhe të realizuara për furnizime publike janë shpallur në SEFP-në (<http://e-nabavki.gov.mk>) dhe në ueb faqen e Fondit (<http://piom.com.mk/nabavki/>) të cilat janë plotësisht të disponueshme për publikun.

Vlera totale e marrëveshjeve të lidhura për furnizime publike në vitin 2021 arrin 114.418.006,00 denarë.

Tabela nr.23 Pasqyrë e numrit dhe e vlerës së kontratave të lidhura sipas llojit të procedurës për dhënien e kontratave për furnizime publike

Lloji i procedurës për dhënie të kontratës	Numri i kontratave të lidhura	Vlera e kontratave të lidhura	%
Furnizim me vlerë të vogël	17	3.939.042,00	3,44
Procedurë e hapur e thjeshtuar	36	60.267.251,00	52,67
Procedurë e hapur	9	49.857.713,00	43,58
Shërbime të veçanta	1	354.000,00	0,31
Gjithsej	63	114.418.006,00	100

Në vitin 2021 nga operatorët e pakënaqur ekonomik në procedurat për dhënie të kontratave për furnizime publike janë parashtruar 3 ankesa drejtuar Komisionit Shtetëror dhe organit kontraktues në formë elektronike, nëpërmjet SEFP-së dhe sipas procedurës së ankimit është sjellë 1 aktvendim për asgjësimin e vendimit-procedurës dhe 2 aktvendime për refuzim të ankesës si e pabazë nga Komisioni Shtetëror i Ankesave për Furnizime Publike.

5. Burimet njerëzore

Në vitin 2021, Seksioni i burimeve njerëzore realizoi politikën e menaxhimit të burimeve njerëzore në Fondin e SPIMV-së, nëpërmjet zbatimit të Ligjit të Marrëdhënieve të Punës, Ligjit të të Punësuarve në Sektorin Publik, Ligjit të Nëpunësve Administrativë, Ligjit të SPI-së, Rregullores së sistemimit të vendeve të punës në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut si dhe Marrëveshjes kolektive për rregullimin, përkatësisht rirregullimin e të drejtave, obligimeve dhe përgjegjësi nga marrëdhënia e punës në Fond.

Në bazë të Ligjit të të punësuarve në Sektorin Publik, është përgatitur plani i punësimit për vitin 2022 dhe plani për trajnimin e nëpunësve administrativë në Fond si dhe raportet mbi realizimin e tyre.

Është përgatitur raport vjetor për masat e shqiptuara mbi përgjegjësinë e vendosur disiplinore dhe materiale.

U miratua procedura për intervistë gjysmëvjetore dhe procedura për vlerësimin e nëpunësve administrativë në Fond dhe në bazë të kësaj është përpunuar edhe Raport për vlerësimin e zbatuar, i cili i është dorëzuar Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe të Administratës.

Janë zbatuar procedura për punësime të reja dhe për avansimin e punonjësve nëpërmjet shpalljeve të brendshme.

U vazhdua përdotësimi i të dhënave të punonjësve nëpërmjet softuerit për burime njerëzore – Hermes, ndërsa në bazë të obligimit nga Ligji i të Punësuarve në Sektorin Publik u vazhdua me regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave për punonjësit e Fondit në Sistemin informatik për menxhimin e burimeve njerëzore (SIMBNJ) të cilin e menaxhon Ministria e Shoqërisë Informatike dhe e administratës.

U vazhdua me evidencën elektronike të orarit të punës në Fond, nëpërmjet përpunimit të raporteve ditore, javore dhe mujore për praninë e punonjësve, komunikimit me Agjencinë e punësimit, zbatimit të fletëparaqitjeve M1-M2, fletëparaqitjeve FNP dhe mosparaqitjeve të punonjësve sipas çdo baze.

Janë zbatuar procedura disiplinore, ndërsa janë zbatuar edhe procedura për transferimin e punonjësve nga institucione të tjera si dhe transferimin e punonjësve nga Fondi në institucione të tjera.

Janë përgatitur aktvendime për: sistematizimin, shqiptimin e masave disiplinuese, përfundimin e punësimit, mungesën e paguar dhe papaguar, pushimin vjetor, kontrata për

punë të pavarur, aktvendime mbi shfrytëzimin e pushimit vjetor si dhe Plani për shfrytëzimin e pushimit vjetor për vitin 2021.

Aktualisht janë përgatitur përgjigje ndaj ankesave të punonjësve të dorëzuara në Agjencinë e Administratës.


Rregullisht është kryer komunikim me shkrim me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, ministritë dhe institucionet e tjera kompetente, përdotësimi i të dhënave për punonjësit në koordinim me Fondin e Sigurimit Shëndetësor për marrjen e kartonëve të sigurimit shëndetësor si dhe për kartelat elektronike shëndetësore. Është përpunuar dhe përditësuar edhe plani i mbrojtjes në Fond.

Në vitin 2021 u vazhdua me monitorimin e rekomndimeve dhe zbatimin e masave për luftën kundër pandemisë me virusin korona (Covid – 19), të sjella nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut dhe rëndësi e veçantë i'u përkushtua mënyrës së organizimit të punës së shërbimeve në kushte pandemie.

Në shërbimin profesional të Fondit me gjendjen e tij në dhjetor të vitit 2021 janë angazhuar 535 punonjës. Në krahasim me vitin 2020 numri është reduktur për 1 punonjës. Struktura kualifikuese e punonjësve është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 24: Struktura kualifikuese e punonjësve në Fond

Përgatitja profesionale	2020	Struktura	2021	Struktura
Superiore	289	53,9	300	56,1
E lartë	42	7,8	41	7,7
E mesme	192	35,8	183	34,2
E ulët	13	2,4	11	2,1
Gjithsej	536	100,0	535	100,0



Struktura e punonjësve sipas përgatitjes arsimore, në vitin 2021 në raport të vitit 2020 është në nivel të përafërt.

Tabela nr.25: Lëvizja e numrit të punonjësve në shërbimin profesional të Fondit në periudhën prej vitit 2007 – 2021.

Viti	Shërbimi profesional, Qendra - Shkup	Njësitë rajonale	Gjithsej
2007	254	430	684
2008	254	462	716
2009	251	427	678
2010	263	474	737
2011	258	451	709
2012	245	432	677
2013	233	421	654

2014	230	406	636
2015	252	393	645
2016	249	388	637
2017	242	366	608
2018	233	354	587
2019	221	338	559
2020	203	333	536
2021	199	336	535

6. Informimi

Në vitin 2021, Fondi i SPIMV-së, siguroi një transparencë aktive dhe llogaridhënie në punën e tij, ndërsa publiku është informur në kohë për të gjitha aktivitetet e rëndësishme. Është vendosur komunikim i vazhdueshëm me mediet me qëllim që të rritet dukshmëria e aktiviteteve dhe ndryshimeve të cilat vendosen në Fond si dhe të informohen qytetarët për shërbimet që i siguron institucioni.

Në këtë drejtim, shërbimet profesionale të Fondit në bashkëpunim me platformën “Vetëm pyet“ incizuan mbi 40 video deklarata që u publikuan në portal. Në video klipet, shërbimet janë drejtuar drejtpërdrejt dhe në mënyrë konkrete u janë përgjigjur pyetjeve të parashtruara më parë nga qytetarët rreth kushteve për pensionim, metodologjisë për llogaritjen e pensioneve, blerjes së stazhit, të drejtës së pensionit invalidor etj.

Gjatë vitit janë transmetuar intervistat me drejtorin e Fondit në disa medie elektronike, medie të shkruara dhe në portale.

Në komunikim me mediet, shërbimi profesional përgatiti përgjigjet e pyetjeve gazetareske mbi tema të dryshme në fushën e sistemit pensional, të cilat u publikuan në medie dhe portale elektronike me ndikim dhe të ndjekura.

Për shkak të nevojës për komunikim, në qershor të vitit 2021 u hap profili zyrtar i Fondit në fejsbuk me qëllim tërheqjen dhe ruajtjen e vëmendjes së qytetarëve dhe informimin e tyre për aktivitetet aktuale.

Në vitin 2021 është realizuar informimi i dyanshëm edhe me punonjësit e Fondit me qëllim të bashkëpunimit dhe komunikimit të ndërsjellë.

Ueb faqja e Fondit përditësohet rregullisht me të dhëna nga statistika, puna financiare, dispozitat ligjore etj., ndërsa janë shpallur edhe tekste aktuale, njoftime të shumta, shpallje, rang – lista për vendosjen e shfrytëzuesve të pensionit në shtëpitë e pensionistëve me të cilat ekonomizon Fondi dhe dokumente të tjera të ndryshme dhe informacione.

Nëpërmjet adresës elektronike të Fondit (info@piom.com.mk) dhe nëpërmjet qendrës – Kol (02/15-215), ku janë evidentuar 1.201 thirrje, qytetarët marrin informacione mbi realizimin e të drejtës së SPI-së, pagesën e pensioneve, dorëzimin e vërtetimeve për jetë të shfrytëzuesve etj.

Në Fond, në vitin 2021 janë përkthyer rregullisht nga maqedonishtja në shqip materialet për 13 seancat e mbajtura të Këshillit Drejtues, tekstet për faqen e internetit si dhe shumë formularë, fletëparqitje, vërtetime lidhur me të drejtat e SPI-së, shkresa nga institucione të jashtme etj.

Në mbështetje të Ligjit të Qasjes së Lirë në Informacionet me Karakteri Publik, në vitin 2021 në Fond janë parashtruar gjithsej 20 kërkesa prej të cilave 17 janë me përgjigje pozitive ndërsa 3 janë negative, në mënyrën dhe formën e caktuar nga kërkuessit. Për këto kërkesa është përgatitur edhe Raport vjetor për zbatimin e të drejtës për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik në Fond.

Në bibliotekën e Fondit e cila disponon me një fond të bibliotekës prej 2.125 titujsh, në përdorim janë dhënë libra profesional, libra me ligje, gazeta zyrtare, lektura, beletristikë (libra leximi), fjalorë, gazeta ditore etj.

7. Punët juridike

Seksioni për punë juridike në vitin 2021 vazhdoi me udhëheqjen e procedurave për kompensimin e dëmit për shkak të pagesës së pabazë të pensioneve; të përgatit padi dhe prashtrës në procedura për gjykatat kompetente dhe të përfaqësojë Fondin në procedurat para gjykatave dhe organeve tjera kompetente. Përveç kësaj personat kompetentë në shërbimin profesional morrën pjesë në punën e ekipeve profesionale gjatë përgatitjes së akteve normative, metodologjisë, udhëzimeve, procedurave dhe udhëzimet nga fushëveprimi i tyre i punës.

Në vitin 2021 janë evidentuar gjithsej 243 lëndë ku kërkesat e Fondit në bazë të pagesës së pabazë të pensionit (dëme) arrijnë gjithsej 17.233.953 denarë, ndërsa prej tyre kanë përfunduar 121 lëndë dhe janë paguar gjithsej 3.158.395 denarë.

Në bazë të pagesës së pabazë të pensionit të përkohshëm invalidor në vitin 2021 janë evidentuar 16 lëndë me gjithsej kërkesa në shumë prej 2.551.981 denarësh prej të cilave janë paguar 453.010 denarë.

Në bazë të pagesës së pabazë të pensionit familjar janë evidentuar 163 lëndë me gjithsej kërkesa në shumë prej 4.931.517 denarësh, prej të cilave janë paguar 2.075.317 denarë.

Janë evidentuar 21 lëndë në bazë të pagesës së pabazë të pensionit të pleqërisë për shkak të punësimit të përfituesit të pensionit, me gjithsej kërkesa në shumë prej 3.651.499 denarësh prej të cilave janë paguar 467.246 denarë.

Në bazë të pagesës së pabazë të pensionit me vlerë më të ulët janë evidentuar 5 lëndë me gjithsej kërkesë prej 618.396 denarë prej të cilave janë paguar 214.100 denarë.

Në bazë të pagesës së shfrytëzuesit të ndjerë të pensionit janë evidentuar 31 lëndë me gjithsej kërkesa prej 2.175.477 denarësh, prej të cilave janë paguar 869.8622 denarë.

Sipas bazave të tjera (aktvendime të asgjësuara për pension të pleqërisë, stazhi fiktiv, aktvendime për pensionim në mbështetje të marrëveshjeve për sigurim social) janë evidentuar 7 lëndë me gjithsej kërkesa në shumë prej 3.305.083 denarësh prej të cilave janë paguar 16.000 denarë.

Në vitin 2021 nga Fondi janë parashtruar 6 padi në baza të ndryshme për pagesën e kërkesës në shumë prej 1.056.152 denarësh. Pas padive të paraqitura për 2 lëndë, të paditurit e kanë paguar kërkesën e Fondit në shumë prej 43.059 denarësh, për 2 lëndë është sjellë aktgjykim i shkallës së parë në favor të Fondit në shumë prej 535.304,00 denarësh, prej të cilave njëra është në procedurë ankimore, ndërsa për tjetrën pritet të jetë e plotfuqishme; edhe për 2 lëndë në gjithsej shumë prej 477.757 denarësh, procedura gjyqësore është në vazhdim.

Në vitin 2021 kundër Fondit janë parashtruar 4 padi prej të cilave: 3 janë në bazë të kontesteve gjyqësore, përderisa 1 padi është në bazë të borxhit – pagesë e interesit për shkak të vonesës me pagesën e pensionit. Nga këto padi, 1 është tërhequr nga paditësi, përderisa, për 3 paditë e tjera procedura gjyqësore ende nuk ka përfunduar.

Në vitin 2021 janë sjellë 17 aktgjykime nga gjykatat kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut, prej të cilave:

- 6 aktgjykime janë sjellë për lëndët për të cilat Fondi është i paditur, ku 2 lëndë kanë përfunduar me aktgjykime në favor të paditësve (Fondi është i obliguar të paguajë 301.259 denarë), përderisa 4 lëndë janë në procedurë ankimore (799.990 denarë).

Nga këto 17 aktgjykime, 11 aktgjykime janë sjellë për lëndët ku Fondi paraqitet si paditës, ndërsa në 4 raste janë sjellë aktgjykime në favor të Fondit për pagesën e kërkesave në gjithsej shumë prej 952.928 denarë, për 1 lëndë me aktgjykim miratohet pjesërisht kërkesa e paditur e Fondit (për pagesë në shumë prej 73.844 denarë), për 1 lëndë është rrefuzuar kërkesa paditëse e Fondit (në shumë prej 369.510 denarë), përderisa për 4 lëndë janë sjellë aktgjykime të shkallës së parë në favor të Fondit (për pagesën e kërkesës

në gjithsej shumë prej 1.030.660 denarësh), por kundër tyre janë paraqitur ankesa nga ana e të paditurve.

Shërbimi profesional në vitin 2021 veprimi edhe për lëndët e viteve të kaluara të cilat ende nuk kanë përfunduar, gjegjësisht nuk janë paguar.

Tabela nr.26

Nr.rend.	baza	numri i lëndëve	kërkesa	të paguara
1	Pagesë e pabazë e pensionit të përkohshëm invalidor	16	2.551.981,00	453.010,00
2	Pagesë e pabazë e pensionit familjar	163	4.931.517,00	2.075.317,00
3	Pagëse e pabazë e pensionit të pleqërisë për shkak të punësimit të përfituesit të pensionit	21	3.651.499,00	467.246,00
4	Pagesë e pabazë e shumës më të ulët të pensionit	5	618.396,00	214.100,00
5	Pagesë e përfituesit të ndjerë të pensionit	31	2.175.477,00	869.862,00
6	Baza të tjera (aktvendime të asgjësuar për pensionin e pleqërisë, stazhi fiktiv, aktvendimet për pensionim në mbështetje të marrëveshjeve për sigurim social).	7	3.305.083,00	16.000,00
	GJITHSEJ	243	17.233.953,00	4.095.535,00

8. Ekonomizimi i pronës së Fondit

Në vitin 2021, Seksioni për ekonomizim me pronën e Fondit ndërmorri aktivitete në lidhje me kompetencat dhe obligimet e saj në mbështetje të Programit për punë të miratuar nga Këshilli Drejtues mbi funksionimin e pandërprerë dhe cilësor të shtëpive për jetesë të përfituesve të pensionit, ekonomizimi i hapësirës banesore dhe afariste, ekzekutimi i Programit për rikonstruimin, adaptimin dhe mirëmbajtje investuese të

objekteve të Fondit sikurse Filialet dhe Qendra poashtu edhe një pjesë e shtëpive të pensionistëve, sigurimi i dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin e objekteve në pronësi të Fondit në evidencën e kadastrit dhe marrja e fletëpronësive.

Aktualish, Fondi i ekonomizon gjithsej 14 shtëpi të pensionistëve. Këto 14 shtëpi të pensionistëve disponojnë me 380 njësi banesore ku janë strehuar përfitues të pensionit.

Qiraja paguhet rregullisht nëpërmjet mbajtjes nga pensioni, ndërsa shpenzimet e tjera (shërbimet komunale) paguhet me më pak vështirësi. Huamarrja totale për vitin 2021 arrin 3.622.203,00 denarë dhe gjithsej mjetet e paguara nga qiratë e përfituesve të pensionit arrijnë 3.629.729,00 denarë ose 100,21% pagesë.

Gjatë lirimimit të apartamenteve në shtëpitë për jetesë të përfituesve të pensionit në mbështetje me rang listën dhe vendimet e sjella nga komisioni, lidhen marrëveshje me përfitues të rinj dhe plotësohen njësitë e lira banesore. Shtëpitë mirëmbahen rregullisht dhe janë krijuar kushte për jetesë të përfituesve të pensionit.

Me miratimin dhe funksionimin e softuerit elektronik për strehimin e përfituesve të pensionit në shtëpitë për jetesë të përfituesve të pensionit u përjashtua mundësia e ndikimit të faktorit subjektiv gjatë zhvendosjes së përfituesve të pensionit në shtëpitë e pensionistëve, sepse rang listat janë shpallur publikisht në ueb faqen e Fondit dhe të gjithë kërkuesit e akomodimit mund të ndjekin përparimin e tyre në rang listë.

Fondi gjithashtu disponon hapësirë afariste në shtëpitë për jetesë të përfituesve të pensionit me sipërfaqe prej 9.564 m² nga e cila 8.374 m² është dhënë me qira, ndërsa 1.190 m² nuk është dhënë. Për dhënien e hapësirës afariste me qira publikohen Shpallje për ankand elektronik publik, ndërsa një komision i posaçëm i Fondit kryen zgjedhjen e ofruesit më të favorshëm dhe pas vendimit të sjellë për zgjidhje lidhet marrëveshje dhe ajo jepet me qira.

Në vitin 2021, Fondi në emër të qirasë për hapësirë afariste ka faturuar 11.930.673 denarë dhe ka paguar 11.422.308 denarë ose pagesa rrjedhëse arrin 95,74%. Në këtë periudhë

nga gjithsej kërkesat e bartura nga periudha e kaluar në shumë prej 6.491.307 denarësh janë paguar 1.595.199 denarë ose 24,57% nga kërkesat e bartura.

Në vitin 2021, Fondi i SPIMV-së i dorëzoi informacion Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut mbi gjendjen me hapësirën afariste. Qeveria e RMV-së e miratoi informacionin dhe solli konkluzion me të cilin obligoi Byronë për Ekspertizë Gjyqësore të bëjë vlerësimin e vlerës së tregut të hapësirave afariste, ndërsa Fondi pas marrjes së vlerësimeve t'i dorëzoi Qeverisë Propozim vendim për shitjen e hapësirës afariste. Ky aktivitet ende është në rrjedhë.

Në vitin 2021, Seksioni vazhdoi me aktivitetet rreth përditësimit të dokumentacionit për regjistrimin e pronës së Fondit në Agjencinë e Kadastrit të Patundshmërive. Për të gjitha objektet me të cilat disponon Fondi dhe të cilat nuk janë regjistruar në pronësi të Fondit, kemi dorëzuar me kohë dokumentacionin e vlefshëm në Ministrinë e Transportit dhe të Lidhjeve, por për shkak të brendësisë së shërbimeve në Ministri, ato ende nuk kanë përfunduar.

Në vitin 2021 janë kryer aktivitete investuese në kuadër të mjeteve të parapara me Buxhetin e Fondit për vitin 2021 me qëllim që të përmirësohen kushtet e punës për punonjësit si dhe me qëllim që të përmirësohen kushtet e qëndrimit të përfituesve të pensionit në shtëpitë e pensionistëve.

- Investime në filiale dhe ekspozitura

Në filiale dhe ekspozitura janë kryer disa aktivitete investuese:

Në Qendrën e Fondit në vitin 2021 është kryer rikonstruimi i hyrjes në Fond duke vendosur trekëmbështa (rolla) për kontroll më të mirë të hyrje – daljeve të punonjësve dhe vizitorëve, është rikonstruktuar një pjesë e katit përdhësë për funksionim më të mirë të arkivit të Fondit. Vlera e punëve të kryera arrin gjithsej 1.416.685 denarë pa TVSH.

Në Filialin e Fondit në Shtip është kryer rikonstruim i plotë i hapësirave duke ndërruar zdrukthtarinë e jashtme, zdrukthtarinë e brendshme, instalime të reja elektrike, lysterje. Vlera e punëve të kryera arrin 2.879.859 denarë pa llogaritjen e TVSH-së.

Në Filialin e Fondit në Probishtip është kryer rikonstruim i plotë i hapësirave me ndërrimin e zdrukthtarisë së jashtme, zdrukthtarisë së brendshme, instalime elektrike të reja, lysterje. Vlera e punëve të kryera arrin 1.435.100 denarë pa llogaritjen e TVSH-së.

- **Investime në shtëpitë për jetesë të përfituesve të pensionit**

Në vitin 2021 Fondi i SPIMV-së ka kryer investim në shtëpinë e pensionistëve në Aerodrom – Shkup me rikonstruim të plotë të konstruksionit të kulmit, me çka është tejkaluar problemi i rrjedhjes së kulmit ekzistues dhe dëmtimit të një pjese të njërive të banimit. Vlera e punëve të kryera arrin 9.824.650 denarë pa llogaritjen e TVSH-së.

Me investimet në vitin 2021 janë përmirësuar ndjeshëm kushtet e punës së punonjësve në Fond si dhe kushtet për jetesë të përfituesve të pensionit në shtëpitë e pensionistëve.

9. Fondi solidar

Në kuadër të detyrave dhe kompetencave të shërbimit profesional të Fondit është edhe grumbullimi dhe pagesa e mjeteve për ndihmë të pasvdekjes – Fondi solidar.

Sipas nenit 115 të Ligjit të Sigurimit Pensionsal dhe Invalidor, përfituesit të pensionit me pëlqimin e tij i ndalohej një shumë e caktuar nga pensioni me qëllim që të sigurojë mjete të nevojshme për pagesën e ndihmës së pasvdekjes për anëtarët e familjes së tij si dhe një pjesë për anëtarësim në Shoqatën e Pensionistëve.

Sipas vendimeve të Organizatës së regjistruar të Lidhjes së Pensionistëve të Maqedonisë për vitin 2021, shuma mujore e mbajtjes nga pensioni për ndihmë të pasvdekjes në muajin dhjetor arrin 120 denarë, e synuar për pagesën e janarit, 130 denarë

në periudhën prej muajit janar deri në prill (e synuar për pagesat nga muaji shkurt deri në maj) dhe 140 denarë nga qershori deri në dhjetor, ndërsa për anëtarësim 30 denarë në muaj.

Ndihma e pasvdekjes e përfituesve të ndjerë të pensionit për vitin 2021 arrin 30.000 denarë.

Tabela nr.27: Lëvizja e mjeteve të ndara dhe të paguara për Fondin solidar -ndihmë e pasvdekjes e përfituesve të pensionit, sipas muajve në vitin 2021

Muajt	Pensionistë me mbajtje për fondin solidar	Mjete të ndara për fondin solidar	Përfitues të ndjerë të fondit solidar	Mjete të paguara për fondin solidar
Janar	307.256	37.467.240	1231	36.930.000
Shkurt	306.452	40.225.640	1356	40.680.000
Mars	306.722	40.376.420	1333	39.990.000
Prill	307.738	40.518.580	1366	40.980.000
Maj	307.276	40.323.520	1327	39.810.000
Qershor	306.899	43.361.790	1478	44.340.000
Korrik	307.432	43.567.000	1440	43.200.000
Gusht	307.771	43.503.970	1463	43.890.000
Shtator	308.514	43.813.070	1458	43.740.000
Tetor	308.583	43.579.470	1455	43.650.000
Nëntor	308.686	43.631.360	1460	43.800.000
Dhjetor	309.195	43.730.790	1445	43.350.000
Gjithsej:		504.098.850	16.812	504.330.000

Në vitin 2021 nga përfituesit e pensionit për Fondin solidar – ndihmë e pasvdekjes janë mbajtur mjete në shumë prej 504.098.850,00 denarësh, përderisa anëtarëve të familjeve të 16.812 përfituesve të ndjerë të pensionit u janë paguar mjete në shumë prej 504.330.000 denarësh.

Në vitin 2021 kishim për obligim pagesë të ndihmës së pasvdekjes për 21.468 përfitues të ndjerë të pensionit në gjithsej shumë prej 644.040.000,00 denarësh, megjithatë për fondin solidar sipas të gjitha bazave (mbajtje, mjete të bartura dhe pagesa) janë akumuluar mjete në shumë prej 505.106.312,00 denarësh. Më 31.12.2021 kanë munguar

mjete në shumë prej 138.933.688,00 denarësh për mesatarisht 4.631 përfitues të ndjerë të pensionit, me këtë vonesa mesatare e pagesës për të gjitha kërkesat e parashtruara ishte rreth tre muaj. Vonesa kishte të bënte me rritjen e vdekshmërisë të pensionistëve në dy vitet e fundit e shkaktuar nga pandemia e KOVID19 dhe shuma e vetë mbajtjes që përcaktohet nga Bordi i Organizatës së regjistruar të lidhjeve të pensionistëve të Maqedonisë . Fondi i SPIMV-së e kryen pagesën me proces të automatizuar të sistemit, kronologjikisht pas datës së parashtrimit të kërkesave.

Tabela nr.28: Në periudhën prej vitit 2010 deri në vitin 2021, mjetet e ndara dhe të paguara për ndihmë të pasvdekjes arrijnë:

Viti	Pensionistë me mbajtje (mesatarja)	Mjete të ndara	Pensionistë të paguar	Mjete të paguara
2010	262.370	377.910.674	12.617	378.501.162
2011	262.179	377.587.680	13.112	393.360.000
2012	265.764	382.711.152	13.219	396.570.000
2013	272.243	392.031.120	13.374	401.220.000
2014	277.609	399.757.920	13.378	401.340.000
2015	281.637	408.042.330	13.712	417.960.000
2016	286.467	416.309.460	13.878	416.340.000
2017	291.502	441.213.820	14.676	440.280.000
2018	296.386	428.943.674	13.402	402.060.000
2019	301.557	438.623.910	14.907	447.222.500
2020	304.733	444.008.590	15.530	465.900.000
2021	307.704	504.098.850	16.812	504.330.000

Numri i përfituesve të ndjerë të pensionit të cilëve u janë paguar mjetet e fondit solidar në vitin 2021 arrin 16.812 përfitues, ndërsa në vitin 2020 arrinte 15.530 të ndjerë, që do të thotë se, numri i përfituesve të paguar të fondit solidar është rritur për 1282 persona në krahasim me vitin 2020.

VIII. SISTEMI I INFORMATIKËS

1. Zhvillimi i sistemit të informatikës

Personat përgjegjës për zhvillimin e sistemit të informatikës në shërbimin profesional të Fondit, për të siguruar shpërndarjen e rregullt të mjeteve të paguara për kontribute që arrinin çdo ditë në llogarinë e menaxhuar nga Fondi, kryenin aktivitete të përhershme të menaxhimit të të dhënave për pagesat e paraqitura nga Trezori me të dhënat mbi LLMPI-në fletëparaqitjet e paguara ,të dorëzuara nga DHP-ja. Me këtë kryhet procesi i shpërndarjes së pagesave dhe të dhënave ndërmjet Fondit të SPIMV-së dhe fondeve pensionale private dhe pas kontrollit të bërë dhe vërtetimit të lëshuar nga MAPAS-ja, një pjesë e parave shpërndahen në llogarinë institucionale të Fondit të SPIMV-së, ndërsa një pjesë shpërndahet në fondet pensionale private. Përveç mjeteve monetare, njëkohësisht shpërndahen edhe të dhënat për çdo person. Ky aktivitet i përhershëm siguron fluksin e parave për pagesën e përfitimeve pensionale.

Janë kryer edhe detyra të vazhdueshme që synonin mirëmbajtjen, plotësimin dhe përmirësimin e aplikacioneve të veçanta, monitorimin e rezultateve të funksionimit të tyre dhe herë pas here, dhe sipas nevojës u bënë ndërhyrje dhe korrigjime në aktvendimet afariste – aplikative që përdoren nga punonjësit e Fondit.

U testua ambienti i ri i punës (versioni 12.2.1.4) me zhvillim të ri të kompjuterëve personalë dhe 64 teknologji thelbësore (instalimi i Forms12, Reports12, WebLogic12) si përgatitje për migrim në mjedisin e përhershëm zhvillimor/prodhimor që është në versionin 9.04. Për shkak të vëllimit dhe kompleksitetit të detyrës, migrimi në vitin 2021 nuk ka përfunduar, por është shtyrë. Lidhur me migrimin e planifikuar në vitin 2021 ka filluar trajnimi për WebLogic12.

Në pjesën afariste të funksionimit të Fondit, nëpunësit kanë nevojë për një shpjegim më të detyjuar të kushteve jo standarde të të dhënave, prandaj organet kompetente për zhvillimin e sistemit të informatikës kanë kryer analiza adekuate dhe

sipas nevojës janë propozuar zgjidhje. Në procesin e kthimit të mjeteve për obliguesit janë kryer 31 analiza dhe ndërhyrje.

2. Softueri aplikativ

Në vitin 2021, vazhdimisht është kryer mirëmbajtja, përsosmëria, përmirësimi dhe kontrolli i funksionimit të të gjitha linjave ekzistuese të aktvendimeve aplikative për mbështetjen e proceseve afariste, edhe atë:

1. Në pjesën e regjistrimit të obliguesve dhe të të siguruarve,
2. Në pjesën e evidentimit amë të shfrytëzuesve të së drejtës dhe pagesës,
3. Në pjesën e vlerësimit të aftësisë për punë (invaliditetit)
4. Në pjesën e digjitalizimit të incizimeve të vjetra mikrofilmike të formularëve M1, M2, M3, M4, M5, M6, M7, M8 dhe Ps,
5. Në pjesën e përgatitjes së pasqyrave me të dhëna për personat e siguruar, obliguesit dhe shfrytëzuesit e të drejtës.

3. Infrastruktura dhe mbështetja e TI-së

Në vitin 2021 vazhdoi furnizimi i pajisjeve të reja moderne të TI-së, me instalimin dhe testimin e funksionimit të tij, me qëllim të funksionimit efikas dhe modern të proceseve afariste të Fondit. Paralelisht me furnizimin e pajisjeve të reja është vazhduar me mirëmbajtjen dhe servisimin e rregullt të atyre ekzistuese duke lidhur marrëveshje me operatorët ekonomikë të autorizuar ku edhe është siguruar funksionimi i vazhdueshëm dhe i papenguar i Fondit. Është zbatuar edhe monitorimi i rregullt, mirëmbajtja dhe konfigurimi i serverëve, mirëmbajtja e sistemit të mbikëqyrjes me kamera, sistemet e alarmit, kontrolli i qasjes dhe evidencës së orarit të punës, monitorimi, mirëmbajtja dhe konfigurimi i pajisjeve të rrjetit, si dhe e ashtuquajtura “Backup” e bazës së të dhënave. E-maillet ditore të arritura nga Trezori, Agjencia e Punësimit dhe nga DHP-ja janë pranuar pa pengesë dhe janë përditësuar të dhënat në bazën e të dhënave. U pranuan dhe u

përditësuan lajmërimet dhe çlajmërimet e përfituesve të pensionit, u dërguan dadotekat e pagesës në banka dhe u ofrua mbështetje teknike për shfrytëzuesit e pajisjeve të TI-së në Qendër, filialet dhe ekspoziturat e Fondit.

VI. KONKLuzion

Raporti për punën e Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë së Veriut në vitin 2021, në mënyrë të plotë paraqet realizimin e të gjitha funksioneve të rëndësishme të zbatimit të sigurimit pensional dhe invalidor të shprehura nëpërmjet treguesve të shumtë statistikorë dhe treguesve të tjerë.

Pjesa hyrëse e raportit në formë të shkurtër i paraqet të gjitha aktivitetet në vitin 2021, ndërsa në vazhdim të raportit në mënyrë krahasuese dhe analitike janë shfaqur rezultatet e realizuara.

Të hyrat e realizuara në vitin 2021 dhe mjetet e bartura monetare nga viti 2020 mundësuan që Fondi rregullisht dhe në kohë të kryejë obligimet ndaj përfituesve të pensionit dhe të drejta të tjera nga fusha e punës së tij si dhe obligime të tjera që dalin nga puna rrjedhëse e Fondit. Të hyrat e rritura për 4,92% në krahasim me vitin 2020 dhe teprica e realizuar e të hyrave në raport të të dalave prej 1.361,1 milion denarësh përfaqësojnë një hap drejt stabilizimit të sistemit pensional.

Pavarësisht pandemisë aktuale, në vitin 2021 Fondi në mënyrë efikase, të suksesshme dhe në kohë ka kryer detyrat e punës dhe ka arritur të realizojë rezultate pozitive financiare.

Personat e siguruar dhe përfituesit e pensionit pa pengesë kanë realizuar të drejtat e tyre në pajtim me ligjin, statutin dhe aktet tjera të përgjithshme të Fondit.

Në kushte të pandemisë, Fondi ka kryer rregullisht pagesën e pensioneve dhe ka bërë përpjekje që t'i paguan ato në javën e fundit të muajit aktual me të vetmin qëllim që përfituesit e pensionit të mos ekspozohen ndaj rrezikut shëndetësor duke u grupuar në

bankat afariste. Harmonizimi i pensioneve është kryer në mbështetje të dispozitave ligjore.

Këshilli drejtues i Fondit në seancën e mbajtur më _____ të vitit 2022, miratoi Raportin të punës së Fondit të SPIMV-së në vitin 2021.

drejtor i Sektorit të çështjeve financiare

Fatime Nexhipi _____

drejtor i Sektorit të realizimit të të drejtave të SPI-së

Biljana Stojanova _____

drejtor i Sektorit të burimeve njerëzore, juridike dhe çështjeve të përgjithshme

Filiz Mehmed _____

drejtor i Sektorit të informatikës

Biljana Davalieva – Mitrevska _____

drejtor i Sektorit të zbatimit të dispozitave të BE-së dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për sigurim social

Nigjar Toska _____

U.D. DREJTORI I FONDIT

Dritan Bexheti

KËSHILLI DREJTUES

Kryetari,

Боро Варошлија